

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**

**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

**УНИВЕРСИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**



**FAKULTETI JURIDIK**

**FACULTY OF LAW**

**ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ**

## **STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**“Ekzekutimi i masave të enteve ndaj fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut:  
2015-2020”**

**KANDIDATI:**

**Kushtrim Karemani**

**MENTOR:**

**Doc. Dr. Blerta Ahmed Arifi**

**Tetovë, 2020**

**“VËRTETOJ SE UNË JAM AUTORI ORIGINAL I KËTIJ PUNIMI”**

**KUSHTRIM KAREMANI**

---

## FALEMNDERIM

*“Prindërit nuk i lënë trashëgim më të mirë fëmijëve të tyre se sa edukatën e mirë.”*

**Profeti Muhamed a.s.**

Së pari, falenderimi i takon Zotit të Madhëruar ndaj të cilit përulem me krenari.

Falenderoj thellësisht dhe u jam mirënjohëse përjetësisht dy personave më të veçantë në jetën time të cilët ishin afër meje në çdo hap të jetës sime duke më ofruar mbështetje të pa kusht emocionale dhe financiare. Falenderoj babain tim, Qenan Karemani dhe nënën time, Flutra Karemani të cilët besuan dhe më përkrahën në çdo sukses timin.

Falenderim i veçantë shkon për vëllaun tim Kreshnik Karemanin dhe bashkëshorten e tij Liridona Karemani, të cilët më kanë përkrahur gjatë gjithë kohës.

Një falenderim nga zemra ua dedikoj edhe gjyshit Nexhebi Karemani dhe gjyshes Gjulasfije Karemani tanimë e ndjerë, të cilët kanë pas rol të veçant në shkollimin tim.

Një falenderim tjetër të përzemërt ia dedikoj të fejuarës time Bukuriye Emruli, e cila më ka mbështetur gjatë kohës së studimeve me dashurin, durim dhe kurajo si dhe duke më dhënë forcë për të përfunduar me sukses këtë punim.

Është shumë e vështirë për të gjetur fjalë të duhura për të shprehur falënderime dhe mirënjohje ndaj mentores time të nderuar Prof. Blerta Arifi Ahmedi, e cila në mënyrë të vazhdueshme më ka ofruar ndihmë profesionale dhe ishte e gatshme që në cdo kohë të më këshilloj, mbështes dhe të më udhëzoj që në kohë të caktuar të arrij finalizimin e këtij hulumtimi, po ashtu një falënderim i veçant shkon për të gjithë profesorët e tjerë të cilët kontribuan me njohurit e tyre gjatë gjithë kohës së studimeve të magjistraturës.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, falenderoj shokun timë Fatmir Murseli për këshillat dhe përkrahjen e vazhdueshme gjatë gjithë kohës së studimeve.

## ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është njohja me funksionimin e ekzekutimit të masave të enteve për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, funksionimin e brendshëm të institucioneve edukuese korrektuese, organizimin e tyre, procesin e riedukimit dhe riintegrimin e fëmijëve në shoqëri, identifikimin e faktorëve pozitiv dhe negativ që janë pjesë e enteve të caktuara shtetërore për tretmane të fëmijëve të gjykuar me masa të ndryshme njohja në mënyr më të detajuar me disa ente ne Republikën e Maqedinisë së Veriut dhe tretmanin që u bëhet fëmijëve gjatë qëndrimit në ent.

Paraqitja e gjendjes reale të këtyre enteve edukuese korrektuese, të dhënat të cilat do të shërbejn për njoftim tëk popullata që të ndikohet në uljen e numrit të veprave të ndaluara. Paraqitja e të dhënave statistikore rreth numrit të fëmijëve që janë të gjykuar, llojin e vepreave për të cilat janë të gjykuar dhe numrin e fëmijëve që janë pjesë e këtyre enteve.

Ligji për drejtësin e fëmijëve është njëri ndër dokumente shtetërore që është shfytëzuar më së shumti në këtë punim, publikime të profesorëve universitar të drejtimit juridik, konventa e organizatës së kombeve të bashkuar. Ligji për drejtësin e fëmijëve është document i cili përfshinë të gjitha etapat e zhvillimit të procesit të ekzekutimit të masave për fëmijët dhe procesit të risocializimit të tyre.

## **ABSTRACT**

The main purpose of this research is to get acquainted with the functioning of the execution of the measures of children's institutions in the Republic of Northern Macedonia, the internal functioning of correctional educational institutions, their organization, re-education process and reintegration of children into society, identification of positive and negative factors of certain state institutions for treatment of convicted children with different measures, acquaintance in more detail with some institutions in the Republic of Northern Macedonia and the treatment given to children during their stay in the institution.

Presentation of the real situation of these correctional educational institutions, data which will serve to inform and influence people to reduce the number of prohibited offenses., presentation of statistical data of the number of convicted children, the type of offenses for which they are convicted and the number of children who are part of these entities.

The Law on the rights of the children is one of the state documents most used in this paper. There is also used publications of university law professors and the United Nations convention. The Law on the rights of the children is a document which includes all stages of the development of the process of execution of measures for children and the process of their re-socialization.

## АПСТРАКТ

Главната цел на овој пројект е да се запознаеме со функционирањето на извршувањето на мерките во институции за деца во Република Северна Македонија, внатрешно функционирање на поправните образовни институции, нивната организација, процесот на реедукација и реинтеграција на деца во општеството, идентификувајќи ги позитивните и негативните фактори кои се дел од одредените субјекти за третман на деца со обид да се признава на подетален начин некои субјекти во Република Северна Македонија и третманот што се прави за децата за време на престојот во тие субјекти.

Презентација на реалната состојба на овие воспитно-поправни институции, податоците што ќе ги служат за информирање на населението за намалување на бројот на забранети дејства. Презентација на статистички податоци за бројот на деца на кои им се суди, видот на прекршоците за што им се суди и бројот на деца кои се дел од овие субјекти. Законот за правата на детето е еден од државните документи што се користат претежно во овој пројект, публикации на универзитетски професори по право, конвенција од Обединетите нации. Законот за правата на детето е документ кој ги вклучува сите фази на развој на процесот на извршување на мерките за деца и процесот на нивната ресоцијализација.

## **Permbajtja**

|                                                                                                                             |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje .....                                                                                                                 | 9  |
| Kapitulli I.....                                                                                                            | 11 |
| 1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E MASAVE<br>EDUKUESE NDAJ FËMIJËVE SIPAS LDF TË RMV-SË .....              | 11 |
| 1.1 Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas LDF .....                                               | 12 |
| 1.2 Mosha minimale për përgjegjësi penale dhe shqiptim të masave ndaj fëmijëve.....                                         | 13 |
| 1.3 Llojet e sanksioneve penale për fëmijë bazuar në specifika të përcaktuara në Ligjin mbi<br>drejtësinë për fëmijët ..... | 14 |
| 1.4 Ekzekutimi i masave edukuese ndaj fëmijëve sipas LDF të RMV .....                                                       | 18 |
| 1.5 Ekzekutimi i masave të enteve ndaj fëmijëve sipas LDF të RMV .....                                                      | 19 |
| 1.6 Kohëzgjatja e masave për fëmijë.....                                                                                    | 20 |
| 1.7 Qëllimi i ekzekutimit të masave ndaj fëmijëve .....                                                                     | 21 |
| 1.8 Rrethanat të cilat duhet të merren parasyshë gjatë matjes gjyqësore për ekzekutimin e<br>masave për fëmijë.....         | 21 |
| 1.9 Shlyerja nga evidence dhe parashkrimi i ekzekutimit të masave për fëmijë.....                                           | 22 |
| Kapitulli II.....                                                                                                           | 24 |
| 2. EKZEKUTIMI I MASAVE PËR FËMIJË DHE TRETMANI I FËMIJËVE.....                                                              | 24 |
| 2.1 Ekzekutimi i masës edukuese të entit Dërgimi fëmiut në ent edukues .....                                                | 24 |
| 2.2 Ekzekutimi i masës edukuese të entit Dërgimi i fëmiut në Shtëpi edukuese-përmirësese<br>.....                           | 25 |
| 2.3 Kohëzgjatjaligjorepërekzekutimin e masavetëentevendajfëmijëve.....                                                      | 25 |
| 2.4 Procesi i riedukimit dhe riintegritimit.....                                                                            | 26 |
| 2.5 Individualizimi i tretmanit penitensiar si kusht për riedukim të fëmijëve.....                                          | 28 |
| 2.6 Institucionet edukuese – përmirësuese për ekzekutimin e masave të enteve për fëmijë.                                    | 29 |
| Kapitulli III .....                                                                                                         | 30 |
| 3. MJETET DHE METODAT E TRETMANIT TË FËMIJËVE TË GJYKUAR.....                                                               | 30 |
| 3.1 Puna e fëmijëve të sanksionuar .....                                                                                    | 31 |
| 3.2 Puna e edukatorit .....                                                                                                 | 32 |
| 3.3 Puna e psikologut.....                                                                                                  | 36 |
| 3.4 Puna e mjekut .....                                                                                                     | 36 |
| 3.5 Arsimi i fëmijëve të dënuar .....                                                                                       | 38 |

|                                                                                                                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 3.6 Aktivitetet zbavitëse dhe sportive.....                                                                                                                         | 40 |
| 3.7 Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmij<br>.....                                                               | 41 |
| Kapitulli IV .....                                                                                                                                                  | 42 |
| 4. ANALIZË EMPIRIKE LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E MASAVE TË ENTEVE NË<br>REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT .....                                                          | 42 |
| 4.1 Analizë e enteve edukuese ku bëhet ekzekutimi i masave edukuese të enteve ndaj<br>fëmijëve në RMV .....                                                         | 42 |
| 4.2 Numri i fëmijëve të gjykuar me masa të enteve gjatë periudhës kohore: 2015-2020 sipas<br>të dhënave statistikore të entit shtetëror statistikor të RMV-së ..... | 45 |
| Përfundim.....                                                                                                                                                      | 54 |
| Rekomandim .....                                                                                                                                                    | 55 |
| Literatura.....                                                                                                                                                     | 57 |



## Hyrje

Hulumtimi i kësaj teme do të kontribuoj në pasurimin e materialeve shkencore në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Evropës Juglindore, lidhur me ekzekutimin e masave ndaj fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tema mbi ekzekutimin e masave për fëmijë do të trajtohet bazuar në legjislacionin pozitiv të sistemit juridiko-penal që rregullon drejtësinë për fëmijë në vendin tonë.

Trajtimi i temës së këtij punimi do të zhvillohet duke u bazuar në burimet kryesore të së drejtës penale për fëmijë: Ligjin mbi drejtësinë për fëmijët të R.M.V.-së dhe Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe në analizimin e instrumentave ndërkombëtare që rregullojnë ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve. Gjithashtu do të konsultohet literaturë bashkëkohore nga sfera e shkencës mbi ekzekutimin e sanksioneve penale - Penologjisë, si ajo vendore dhe ndërkombëtare. Poashtu do të paraqitet dhe analizohet numri i fëmijëve të sanksionuar me masa të ndryshme për fëmijë bazuar në të dhënat e publikuara nga Enti Shtetëror statistikor i RMV-së.

Gjatë këtij hulumtimi do të përdoren metoda të ndryshme, si:

- Metodologjia *teorike* (Metoda juridike; Metoda krahasuese; Metoda sociologjike; Metodatat psikologjike dhe logjike), dhe
- Metodologjia *empirike* (Metoda statistikore; Metoda e analizës dhe sintezës; Metoda e vështimit, metoda përshkruese, Anketa dhe Intervista).

Hulumtimi do të bazohet në të dhëna nga autorë kompetentë të cilët kanë trajtuar të drejtën penale për fëmijë. Do të respektohen rregullat e shfrytëzimit të njohurive deri tek të cilat do të arrihet. Poashtu do të respektohet rendi shtëpiak në të gjitha institucionet që do të vizitohen gjatë hulumtimit shkencor. Materiali faktografik që do të përdoret do të konsistojë në sigurimin e rezultateve të nevojshme me të dhëna zyrtare nga Enti shtetëror statistikor i RMV-së lidhur me numrin e fëmijëve të gjykuar dhe atyre të dënuar me burg gjatë periudhës kohore 2013-2018.

Poashtu do të realizohet Anketë me fëmijë të cilëve -janë ekzekutuar masa, si dhe Intervistë me personelin e entit për fëmijë – konkretisht me Edukatorin dhe me psikologun e entit për fëmijë.

Në këtë punim hulumtues do të parashtrohen disa pyetje kërkimore, të cilat do të paraqesin drejtimin e hulumtimit të temës së përcaktuar për hulumtim.

Hipotezat e parashtruara janë:

1. Ekzekutimi i masave për fëmijë *de lege* është i rregulluar konform kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare të drejtësisë për fëmijë. Kjo hipotezë do të vërtetohet duke i analizuar dokumentet ndërkombëtare të cilat e rregullojnë sferën e drejtësisë për fëmijë, duke filluar nga Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve si dhe dokumente të tjera ndërkombëtare të cilat janë të rëndësishme për ç'do shtet i cili pretendon të plotësojë kërkesat ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve.

Ekzekutimi i masave ndaj fëmijëve has në ngecje në drejtimin *de facto* kur ndaj fëmijut ndërmerren masa në kuadër të tretmanit penitenciar në entin e caktuar korrektues ndëshkues ku ekzekutohet ky lloj i masës. Kushtet të cilat ofrohen nga ana e shtetit në këtë ent nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme që tek fëmijët e sanksionuar të arrihet efekti i këtij dënimi- edukimi, socializmi, si dhe prevencioni special. Kushtet sanitare, numri i personalit si dhe programet joadekuate për riedukim të fëmijëve të sanksionuar paraqesin problematikë shumë serioze e cila në praktikë nuk lejon që ekzekutimi i masave ndaj të fëmijëve të arrijë efektin e kërkuar.

## Kapitulli I

### 1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E MASAVE EDUKUESE NDAJ FËMIJËVE SIPAS LDF TË RMV-SË

Për secilin veprim të kryer nga fëmijët të cilët veprime janë të kundërligjshme do të zbatohen sanksione sipas Kodit penal dhe ligjeve të tjera përkatëse. Një ndër mënyrat e ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj fëmijëve janë edhe masat edukuese, qëllimi i të cilave është të mbrohen nga kriminaliteti, dhuna dhe nga cdo formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre.

Për cdo veprim që është paraparë përgjegjësi penale të fëmijët që janë deri në moshën 14 vjeçare do ti shqiptohen masa edukuese, cilat janë rregullat dhe masat edukuese do të thiremi në ligjin për drejtësinë e fëmijëve.

Sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve parashihen këto rregulla lidhur me ekzekutimin e masave edukuese për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fëmijës mbi moshën 14 vjet për veprime që me ligj është paraparë si vepër penale që mund t'i shqiptohen masat edukuese në vijim<sup>1</sup>:

- a) Masa qortimi ose dërgim në qendrën për fëmij;
- b) Masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ëve, familja përkudësës ose qendra;
- c) Masat e entit dërgim në institucione edukuese ose në shtëpi edukuese-përmisuese

Masa qortimi ose dërgim në qendrën për fëmijë - i kumtohet fëmijës kur nuk ekziston nevoja për masa më të gjata të edukimit, e në vecanti nëse ka kryer veprime me të cilat me ligj është paraparë si vepër penale nga pamaturia ose mendjelehtësia.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar - i shqiptohen fëmijës kur ekziston nevoja nga masa më të gjata të edukimit riedukimit ose mjekimit me mbikëqyrje përkatëse, e nuk nevojitet ndarje e plotë e tyre nga mjedisi i deritanishëm.

Masat e entit i shqiptohen fëmijës kur ekziston nevoja nga masa të gjata të edukimit, riedukimit ose mjekimit dhe vecim të plotë nga mjedisi i deritanishëm. Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet, por më së shumti deri më mbushjen e 23 viteve.

Me ekzekutimin e masave edukuese tentohet aftësimi i tyre profesional dhe zhvillimi i drejtë mental, tentohet që masat të zbatohen në mënyrë sa më profesionale dhe të njejtat ti

---

<sup>1</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta zyrtare e R.M.V-së, nr.148/2013, neni 37

përgjigjen personalitetit të tyre të kenë efekt pozitiv dhe të sigurohet risocializimi dhe riintegrimi i tyre.

### 1.1 Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas LDF

Fëmijë llogaritet çdo qenie njerëzore prej fazës së lindjes e deri në pubertet, si në shumë shtete të botës gjithashtu edhe në republikën e Maqedonisë së Veriut sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve, fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjet.

Ligji për drejtësinë e fëmijëve në mënyrë të detajuar rregullon çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve që janë në konflikte ligjin apo përfaqësojnë viktimat e krimit, përveç kategorizimit të fëmijëve në ndarje të caktuara sipas moshës dhe cilësive, ky ligj parasheh të gjitha llojet e sanksioneve penale dhe përcakton kushtet në të cilat mund të shqiptohen ato ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale<sup>2</sup>.

Kategorizimi i fëmijëve sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve është në këtë mënyrë<sup>3</sup>:

- **Fëmijë**– është çdo person deri në moshën 18 vjet;
- **Fëmijë në rrezik**– çdo fëmijë që i ka mbushur 7 vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhillimit mental, vikimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizmi i funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/eve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve të këtylla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është parapra si vepër penale;
- **Fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose burgim mbi 3 vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 7 vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet.
- **Fëmijët në rrezik nga 14 deri 18 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me

<sup>2</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në RM gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq.24

<sup>3</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 19

para ose dënim me burg deri në 3 vite ose vepër e parapar me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet.

- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimi të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi 3 vite i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet.
- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi 3 vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet.
- **Fëmijë viktimë**- është çdo fëmijë i moshës deri 18 vjet i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësim emotiv, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale.
- **Person më i ri i moshës madhore** – është personi i cili gjatë kohës së gjyqimit për veprim të parapar me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet.

## **1.2 Mosha minimale për përgjegjësi penale dhe shqiptim të masave ndaj fëmijëve**

Veprimet të cilat kryhen nga fëmijët prej moshës 14 deri 16 veprime që me ligj parashihen si vepra penale nuk do t'iu shqiptohen dënim por vetëm masë edukuese, ndërsa fëmijëve prej moshës 16 deri 18 vjet mund ti shqiptohen masë edukuese e me përjashtim edhe dënim e masë alternative.

Sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve mund të dënohet një fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arritur atë 16 vjeçare, përveç rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme për shqiptim të masës edukuese, për këtë rast prof.dr. Vlado Kambovski thekson se kushtet ligjore për shqiptimin e dënimeve janë të përcaktuara në frymën e konceptit retributive, sipas ligjit (mos) arsyetimi për shqiptimin e masës edukuese nuk e lidh personalitetin e fëmijut dhe qëllimin e masës edukuese, por për pasojat e rënda të veprës dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, kjo në fakt nuk nënkupton gjë tjetër pos pranimit të parimkit të dënimit proporcional dhe mund të mbrohet vetëm prej pozicionit të vetëm: ekzistimi i shkallës së lartë të përgjegjësisë penale tek i mituri. Me të drejtë ai vleron se shqiptimi i dënimit

mund të paraqitet si sanksion jashtëzakonisht i dobishëm për arritjen e qëllimi që është edukimi dhe riedukimi i fëmijut<sup>4</sup>.

Gjatë zgjedhjes së masës edukuese gjykata I mer parasysh moshën e fëmijës, shkallën e zhvillimit të tij shpirtëror, cilësitë e tij psikike, prirjet, nxitjet nga të cilat e ka kryer veprimin, si dhe të gjitha rrethana që ndikojnë në caktimin e llojit të masave për aritjen e qëllimit të tij të përcaktuar me ligj<sup>5</sup>.

Qëllimi i shqiptimit të masave ndaj fëmijëve është në interes të fëmijëve për mbrojtjen e tyre, edukimin, riedukimin, dhe zhvillimit të drejtë të tyre, gjatë vendosjes për shqiptimin e masave ndaj fëmijëve u jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese.

### **1.3 Llojet e sanksioneve penale për fëmijë bazuar në specifika të përcaktuara në Ligjin mbi drejtësinë për fëmijët**

Ndaj fëmijëve të cilëveu takon përgjegjësia penale dhe që bien ndesh me ligjin, sipas Ligjit mbi drejtësinë për fëmijët mund që tu shqiptohen këto lloje të sanksioneve<sup>6</sup>:

- Masa edukuese;
- Dënime;
- Masa alternative;
- Masa siguruese.

**Masat edukuese** - Masat edukuese janë lloj i sanksioneve penale, të parapara me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve, të cilat i'u shqiptohen fëmijëve në ndeshje me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare. Këto paraqesin lloj të posaçëm të sanksioneve penale të cilat mund t'i u shqiptohen ekskluzivisht vetëm fëmijëve kryerës të veprave penale, këto masa përbëhen në mbrojtjen, mbikqyrjen, aftësimin profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë personale të të miturit dhe kanë për qëllim edukimin e tij, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë<sup>7</sup>.

---

<sup>4</sup> Kambovski V. 2010, E drejta Penale, Shkup, fq.612

<sup>5</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta zyrtare e R.M.V-së nr148/2013, neni 38

<sup>6</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 34

<sup>7</sup> Kambovski V. 2007, E drejta Penale, fq. 607

Qëllimi i masave edukuese vërehet nga vetë emërtimi i tyre, i cili konsiston në edukimin apo riedukimin e fëmiut delikuent, parandalimin e veprimeve delikuede e asociale nga fëmijët, socializimin e fëmiut në shoqëri, e assesi dënimit apo shpagimit për të keqen e shkaktuar<sup>8</sup>.

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve në Republikën e Maqedonise së veriut njih 3 lloje të masave edukuese të cilat mund ti shqiptohen fëmiut që ka arritur moshën 14 deri 18 vjeçare, ato janë<sup>9</sup>:

- a. Qortimi ose dërgimi në qendër për fëmijë;
- b. Masat e mbikqyrjes së përforcuar nga ana e prindërit/ëve, tutorit/ëve, familjes përkujdesëse ose qendrës;
- c. Masat e entit- Dërgimi në institucion edukues ose Dërgimi në Shtëpi edukuese-përmirësuese.

**Dënimet** – sipas ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve mund të dënohet një fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arritur atë 16 vjeçare, përveç rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme shqiptimi i masave edukuese<sup>10</sup>.

Llojet e dënimeve janë<sup>11</sup>:

- a. Burgu për fëmijë;
- b. Dënimi me para;
- c. Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik ose kategorisë së caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi.

**Burgu për fëmijë** - dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm në rastet kur fëmija ka kryer vepër penale për të cilën parashihet dënim prej 5 vitesh burg ose dënim më i rëndë Sipas Ligjit për drejtësi të fëmijëve, dënimi me burg është dënim kryesor dhe si I tillë mund të shqiptohet, në rastet kur vepra e kryer në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale do të shqiptohet dënim me burg pasi nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masë edukuese. Burgu për fëmijë nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vit dhe më i gjatë e 10 vite kurse shqiptohet në vite të plota ose gjysëm viti.

---

<sup>8</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në RM gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq.39

<sup>9</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 37 p.1

<sup>10</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 50

<sup>11</sup> Po aty, neni 51

Gjatë caktimit të dënimit, gjykata nuk mund të shqiptojë burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë nga dënimi i përcaktuar për atë veprë, por gjykata nuk është e lidhur për masën më të vogël të përcaktuar të atij dënimi. Kështu p.sh. kur si maksimum i posaçëm për veprën e kryer është përcaktuar dënim me burg deri 8 vjet, gjyqi nuk mund të shqiptojë dënim mbi atë maksimum, por gjithmonë mund të ulet nën minimumin e përgjithshëm të dënimit me burg deri në 1 vit kohëzgjatje<sup>12</sup>.

Fëmijëve të cilëve u është shqiptuar dënim me burg kanë mundësi të lëshohen në lirim me kusht, në rastet kur ka vuajtur një të tretën e dënimit por jo para se të vuaj një vit nga dënimi i shqiptuar, lirimin me kusht mund ta fitojnë në rastet kur riedukimi është i sukseshëm, fëmijët qëllohen në lirim me kusht gjatë gjithë kohës janë në mbikëqyrje të përforcuar. Gjykata do të revokoi lirimin me kusht në rastet kur fëmija nuk i plotëson obligimet e parapara ose kryen veprime të kunderligshme për të cilat është paraparë dënim me burg për fëmijë mbi dy vite.

**Dënim me para** – shqiptohet si dënim kryesor për veprat e kryera nga lakmia e përfitimit, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për fëmijë ose dënimin me kusht me mbikëqyrje të përforcuar, dënimi me para shqiptohet me gjyba ditore ndërsa numri i gjybove nuk mund të jetë më i vogël se 1 as më i madh se 120 gjyba ditore lidhur me matjen dhe zbatimin e dënimit me para në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Kodit Penal<sup>13</sup>.

Në rastet kur fëmiju i dënuar nuk mund të paguaj gjyben e shqiptuar ose dënimin me para në vend të dënimit me burg mund të zëvendësohet me dënim për punë në dobi të përgjithshme, poashtu gjykata mund ta zëvendësoi edhe me dërgim në qender për fëmijë ose me masën e mbikëqyrjes së përforcuar.

**Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi**– Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi mund të shqiptohet si dënime kryesore ose dytësore së bashku me dënimin me para<sup>14</sup>.

**Masat alternative** – fëmijut mbi moshën 16 vjet që mbartë përgjegjësi penale mund ti shqiptohet masë alternative qëllimi i të cilës është që të mos zbatohet dënimi kur kjo nuk është e

<sup>12</sup> Kambovski V. 2007, E drejta Penale, Shkup, fq. 612

<sup>13</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 54

<sup>14</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në RM gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq.50



detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritët se paralajmërimi me kërcënim të dënimit dhe zbatimi i masave të ndihmës, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikoj në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij.

Llojet e masave alternative janë<sup>15</sup>:

- a. Dënimi me kusht me mbikëqyrje të përforcuar;
- b. Nënprerje me kusht të mbajtjes së procedurës ndaj fëmijut;
- c. Puna në dobi të përgjithshme.

Dispozitat e Kodit penal për masa alternative vlejnë edhe përshqiptimin e tyre ndaj fëmijëve mbi moshën 16 vjet, nëse me ligjin për drejtësinë mbi fëmijët nuk është përcaktuar ndryshe, qëllimi i masave alternative është që për përgjegjësi penale ndaj fëmijut mbi moshën 16 vjet të mos zbatohet dënim kur kjo nuk është e detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritët se paralajmërimi me kërcënim të dënimit dhe zbatimi i masave ndihmëse, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikojë në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij<sup>16</sup>.

**Masat siguruese** –masat e sigurisë mund të shqiptohen sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve nën kushte të përcaktuara me Kodin Penal ndaj fëmijut të gjykuar me masën edukuese ose dënimin me burg për fëmijë, ndaj fëmijut të papërgjegjshëm nën kushtet e përcaktuara me Kodin Penal.

Masat e sigurisë që mund të shqiptohen janë<sup>17</sup>:

- a. Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor;
- b. Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri;
- c. Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve nga Kodi penal, si masë e mjekimit të detyrueshëm të fëmijut nga varshmëritë, mund të shqiptohet dhe pas shqiptimit e masës edukuese ose dënimit. Kur masa Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve shqiptohet me masën edukuese ose dënimin, ajo zbatohet në seksion të specializuar të institucionit, koha e kaluar në institucion për zbatimin e masës së sigurisë llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg për fëmijë ose

---

<sup>15</sup>Po aty, fq. 51

<sup>16</sup>Ahmedi Arifi B. 2019, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në RM gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq.53

<sup>17</sup>Po aty, fq. 53

masës së entit, pas zbatimit të masës së sigurisë, gjykata do të vendosë nëse do të vazhdojë realizimi i dënimit me burg për fëmijë apo masa e entit.

#### **1.4 Ekzekutimi i masave edukuese ndaj fëmijëve sipas LDF të RMV**

**Masat edukuese** - Masat edukuese janë lloj i sanksioneve penale, të parapara me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve, të cilat i'u shqiptohen fëmijëve në ndeshje me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare. Këto paraqesin lloj të posaçëm të sanksioneve penale të cilat mund t'iu shqiptohen ekskluzivisht vetëm fëmijëve kryerës të veprave penale, këto masa përbëhen nëmbrojtjen, mbikqyrjen, aftësimin profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë personale të të miturit dhe kanë për qëllim edukimin e tij, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë<sup>18</sup>.

Qëllimi i këtyre masave është edukimi apo riedukimi i fëmijut delikuent, socializimi në shoqëri, zhvillimi i drejt i tyre, vlen të ceket se qëllimi i këtyre masave nuk është dënim apo shpazim për të keqen që kanë shkaktuar, bëhet fjalë për masa të udhëhequra prej idesë preventive. Pra, qëllimi i politikës penale represive dhe preventive është përmisimi i fëmijëve delikuntë, që në të ardhmen të mos e përsërisin veprimin e njejtë apo të ndryshëm kundërligjor (qëllimi i parandalimit special)<sup>19</sup>.

Gjatë zgjedhjes së masës edukuese gjykata i merr parasysh moshën e fëmijës, shkallën e zhvillimit të tij shpirtëror, cilësitë e tij psikike, prirjet, nxitjet nga të cilat e ka kryer veprimin, edukimin e deritanishëm, mesin dhe rrethanat në të cilat ka jetuar, peshën e veprimit të kryer, nëse ndaj tij më parë është shqiptuar masë edukuese ose dënim me burg për fëmijë dhe të gjitha rrethanat tjera që ndikojnë mbi caktimin e llojit të masave për arritjen e qëllimit të tij përcaktuar me ligj.<sup>20</sup>

**Llojet e masave edukuese** – ligji mbi drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë masat edukuese i kategorizon në 3 lloje të masave edukues që u shqiptohen fëmijëve që kanë arritur moshën 14 deri 18 vjeçare, për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale, ato janë:

- Masat të qortimit ose dërgimit në qendrën për fëmijë
- Masat e mbikëqyrjes së përforcuar
- Masat e enteve

<sup>18</sup> Kambovski V. 2007, E drejta Penale, fq. 607

<sup>19</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Dispens/Delikuenca e të miturve, Tetovë, fq.55

<sup>20</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr.148/2013 neni 38

Për ekzekutimin e masave edukuese, kompetentë që të veprojnë janë gjyqi kompetent dhe qendra për punë sociale sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të personit të mitur ndaj të cilit zbatohet masa edukuese<sup>21</sup>.

Gjatë ekzekutimit të masave edukuese, kemi shpenzime të shumta të cilat duhet mbuluar, të gjitha këto shpenzime bien në llogari të organit gjëgjësisht institucionit që e zbaton masën edukuese, nëse me ligj nuk është e paraparë ndryshe.

### **1.5 Ekzekutimi i masave të enteve ndaj fëmijëve sipas LDF të RMV**

**Masat e enteve** ekzekutohen me vendim të gjykates ndaj fëmiut, pas shqiptimit të ndonje nga masat e entit qendra për punë sociale do te kërkoj nga prindi, adoptuesi ose kujdestari i fëmiut ndaj të cilit është shqiptuar kjo masë që në ditën e percaktuar gjatë 15 ditve ta sjellë fëmiun në institucion, po ashtu institucioni kompetent do ta njëftoi fëmiut për datën se kur duhet të paraqitet për ekzekutimin e masës së entit. Nëse fëmiu nuk paraqitet për zbatimin e masës së entit udhëheqësi i institucionit do të njoftoj gjykatën kompetente dhe njësin rajonale të ministrisë së punëve te brendëshme për kapjen e fëmiut.

Institucioni në të cilin zbatohet masa e entit më së vonti 3 muaj para lëshimit të fëmiut nga institucioni duhet të njoftoj qendrën për punë sociale dhe ti propozoj masat për edukimin e fëmiut.

Gjatë ekzekutimit të masave të entit kujdes dhe rëndësi të madhe I kushtohet raporteve familjare të fëmiut, poashtu rëndësi i kushtohet dhe sigurimit të ushqimit të tij të përkohshëm nëse kjo nuk është siguruar nga familja si dhe veshmbathje.

Masat e entit sipas ligjit për drejtësin e fëmijëve ndahen në:

- Dërgim në institucion edukues
- Dërgim në shtëpi edukuese përmisuese

Fëmiu, prindi, adoptuesi apo kujdestari kanë të drejt që të kërkojnë të shtyn fillimin e ekzekutimit të masave të entit.

---

<sup>21</sup>Osmani A. 2013, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, fq.329, neni 279

## 1.6 Kohëzgjatja e masave për fëmijë

Kohëzgjatja e masave për fëmijë në pjesën dërmuese të masave është e papercaktuar, për shkak se masat kanë për qëllim që të ndikojnë në edukimin dhe riedukimin e fëmijëve, socializimin e tyre e nuk kanë për qëllim që ti dënojnë ata.

Kohëzgjatja e masave në shumicën e rasteve varet nga vetë fëmiju se sa shpejtë do ti zbatoj, kuptoj masat që i janë shqiptuar, por varen edhe nga institucionet se sa janë në gjendje që të ju ofrojnë kushte për zbatimin e masave ndaj fëmijëve, edukatorët se sa me përgjegjësi si e kryen punën e tyre, gjithashtu kohë zgjatja e masave varet dhe nderlidhen edhe njera me tjetren sepse masat fillojnë të zbatohen ndaj fëmijut prej masave më të lehta deri tek ato më të rënda, në përjashtim kur fëmiju me përgjegjësi penal ka kryer veprë të rëndë penale ku edhe i caktohet dënim me burg për fëmijë e cila gjithashtu ndërlidhet me masë pasi disa masa caktohen kur vecmas fëmijut i është shqiptuar dënim me burg si psh tek, masat alternative- dhe nimi me kusht me mbikëqyrje të përforcuar mund të shqiptohet kur fëmiju i është caktuar dënim me burg me kohëzgjatje prej tre vitesh ose dënim me para, në këtë rast kohën e kontrollit gjykata e cakton në kohëzgjatje që nuk mund të jetë më e shkurtër se një e as më e gjatë se tre vite.<sup>22</sup>

Sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve kohëzgjatja tek masat edukuese është e cekur si në vijim:

- Masat e mbikëqyrjes së përforcuar – nuk mund të zgjasin më pak se një vit dhe as më gjatë se tre vite.<sup>23</sup>
- Masat e entit – dërgimi në institucione edukuese fëmiju mbetet së paku gjashtë muaj e më së shumti tri vite.<sup>24</sup>
- Dërgimi në shtëpi edukuese përmirësuese – mbetet së paku një vit, e më së shumti pesë vite ose deri në mbushjen e 23 viteve.<sup>25</sup>

Kurse te masat e sigurisë kohëzgjatja e kësaj mase e përcakton - koha e kaluar në institucion për zbatimin e masës së sigurisë llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg për fëmijë ose masës së entit.<sup>26</sup>

<sup>22</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve 2013, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr.148/2013, neni 62 p.2 p.4

<sup>23</sup> Po aty, neni 41 p.3

<sup>24</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve 2013, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 148/2013, neni 45 p.2

<sup>25</sup> Po aty, neni 46 p.3

<sup>26</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Dispens/Delikuenca e të miturve, Tetovë, fq.70

### **1.7 Qëllimi i ekzekutimit të masave ndaj fëmijëve**

Qëllimi i ekzekutimit të masave janë realizimi i interes prioritar dhe mbrojtjes të fëmijëve nga kriminalitet, dhuna dhe nga cila do form e rezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre, zhvillimit të tyre të drejtë, mbrojtja e fëmijëve nga përsëritja e atyre veprave, socializimi i tyre, edukimi dhe riedukimi, garantimi i lirive dhe të drejtave të tyre në bazë të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe të drejtave të parapara me konventa dhe marveshje ndërkombëtare të ratifikuara dhe në pajtim me kushtetutën e republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përgjithësi ekzekutimi i masave ka për qëllim dhënjen e mbrojtjes dhe ndihmës të fëmijëve, aftësimi të tyre profesional dhe zhvillimit të tyre personal.

Rol të rëndësishëm në ekzekutimin e masave ndaj fëmijëve dhe realizimin e qëllimit të ekzekutimit të masave kanë organizata të ndryshme ndërkombëtare e vecanërisht Organizata e Kombeve të Bashkuara sipas të cilës:

Të gjitha aktivitetet që I ndërmarrin institucionet private, shtetërore, gjyqet kanë interesin e tyre primar të të drejtave të fëmijëve, secili shtet ka për obligim mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve që është e domosdoshme për zhvillimin e tij, duke i pranuar të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe personave të tjer që janë juridikisht përgjegjës për fëmijun<sup>27</sup>.

### **1.8 Rrethanat të cilat duhet të merren parasysh gjatë matjes gjyqësore për ekzekutimin e masave për fëmijë**

Rrethanat që merren parasysh gjatë matjes gjyqësore për ekzekutimin e masave për fëmijë janë:

- Shkalla e përgjegjësisë penale- duhet pasur parasysh se cila ka qenë mënyra e kryerjes së veprimit të ndaluar, e cila mund të jetë nga pakujdesia me vetëdije apo pa vetëdije.
- Motivet nga të cilat është kryer vepra penale- në shumë raste të fëmijët paraqiten problem psikike, motive të cilat mund të shtyjnë fëmijën të krye vepër penale mund të jenë të ndryshme si dhembshuria, dashuria, xhelozia, urrejtja, egoizmi etj.
- Pranimi i fajit – konsiderohet si një ndër rrethanat më të rëndësishme që do të ndikojnë në matjen e masës gjyqësore. Sipas kësaj teorie në qoftëse fëmiju do të pranojë se ka kryer vepër penale do të pranon fajin do të kupton se veprimi i tillë i ka shkaktuar

---

<sup>27</sup> Convention on the Rights of the Child- (CRC)

dëm personit tjetër dhe shoqëris, kjo jep shenjë se fëmiju është penduar dhe kjo rrethanë duhet të jetë lehtësuese gjatë matjesë gjyqësore, mirëpo në rast të kundërt nëse fëmiju nuk pranon fajin kjo jep shenjë se ai nuk e ka kuptuar apo nuk dëshiron ta kuptoi se ka kryer veprime të dëmshme të cilat me ligjin për drejtësin e fëmijeve është paraparë si vepër penale dhe kjo rrethanë mund të jetë indikacion se fëmiju në të ardhmen do të kryej vepër penale.

Gjykata do ti marrë parasysh të gjithë rrethanat të përcaktuara në kodin penal, duke mbajtur llogari të vecant për shkallën e zhvillimit shpirtërorë, mendor të fëmijës dhe për kohën e nevojshme për edukimin, riedukimin dhe përsosjen profesionale<sup>28</sup>.

Gjatë marrjes së vendimit duhet doemos të merren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që janë shprehur në momentin e kryerjes së veprës penale, në mënyrë që të caktohet ai lloj masës apo dënimi i cili do ti përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit dhe me të cilën më së miri do të arrihet qëllimi<sup>29</sup>.

Pra rrethanat që do të merren parasysh gjatë matjes së masës gjyqësore janë në të mirë të fëmijëve, për dallim nga dënimi për të ritur, te fëmijët këto masa konsiderohen si masa me anë të sëcilës nuk tentohen shpagimi i fajit, por vetitë dhe karakteristikat personale të fëmijës të cilat u përmende më lartë që do të ndikojnë në përmirësimin dhe adaptimin e tij në shoqëri në të ardhmen.

### **1.9 Shlyerja nga evidence dhe parashkrimi i ekzekutimit të masave për fëmijë**

Evidencën e masave të shqiptuara ndaj fëmijëve e mban gjykata kompetente sipas vendlindjes, gjykata është e obliguar që më së voni deri në ditën e pestë të muajit ti dorëzojë evidencë të masave të shqiptuar për muajin paraprak, në gjykatën themelore Shkupi I Shkup që mban regjistër unik për Republikën e Maqedonisë. Të dhënat për sanksionet e shqiptuara mund ti jepen vetëm gjykatës, prokurorit publik dhe institucioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve<sup>30</sup>.

Të dhënat për masat e shqiptuara qortim ose dërgim në qendër të fëmijëve, masat e mbikëqyrjes së përforcuar dhe sanksionet kundërvajtëse fshihen nga evidence kur do të kalojë një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre, nëse fëmiju në atë afat nuk kryen vepër penale të re që është paraparë me ligj si vepër penale. Të dhënat për gjykim me kusht me mbikëqyrje të

<sup>28</sup> Salihu I. 2012, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, fq.491-492.

<sup>29</sup> Ligji për drejtësin e fëmijëve, 2013, Gazeta Zyrtare e R.M.V, Nr. 148/2013, neni 52.

<sup>30</sup> Ligji për drejtësin e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e RMV-ës, 2013, neni 72.

mbrojtur fshihen nga evidenca pas një viti kalimi i kohës për kontroll, nëse fëmiju ose personi më i ri I moshës madhore në atë afat nuk kryen vepër të re që është parapa me ligj si vepër penale.

Të dhënat për masat e shqiptuar nga enti, dënimi në para si dhe masat alternative fshihen nga evidence kur do të kaloj një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre, nëse fëmiju në atë afat nuk kryen veprim të ri që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje. Kur plotësohen kushtet e përcaktuara nga ligji për drejtësin e fëmijëve sipas nenit në paragrafet 1 deri në 4, të dhënat për sanksionet e shqiptuar fshihen nga evidenca, kurse të gjitha dokumentet asgjesohen me fuqi ligjore<sup>31</sup>.

Parashkrimi i zbatimit të masës alternative për punë me dobi të përgjithshme, masave të sigurisë dhe sanksioneve kundërvajtëse, krijohet kur do të kaloj 1 vit nga dita e plotëfuqishmërisë së vendimit me të cilin janë shqiptua, parashkrimi i zbatimit të masës edukuese nga entet, dërgimi në shtëpi edukuese përmisuesë, krijohet kur do të kalojnë 5 vjet nga dita e plotëfuqieshmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar ajo masë edukuese.

Parashkrimi i zbatimit të masës së entit për dërgimin e fëmijës në institucion edukues dhe të masave të mbikqyrjes së përforcuar, krijohet kur do të kalojnë 3 vite nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin janë shqiptuar ato masa edukuese. Parashkrimi i masës disiplinore edukuese dërgimi në qendër për fëmijë, krijohet kur do të kalojnë 6 muaj nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është krijuar kjo masë edukuese<sup>32</sup>.

---

<sup>31</sup> Ligji për drejtësin e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e RMV-ës, 2013, neni 73.

<sup>32</sup> Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta zyrtare e R.M.V-së, nr.148/2013, neni 74

## Kapitulli II

### 2. EKZEKUTIMI I MASAVE PËR FËMIJË DHE TRETMANI I FËMIJËVE

Në Republikën e Maedonisë së Veriut në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar është formuar sector i specializuar për kriminalitetin e të miturve i përbër nga: Gjykatësi për të mitur, këshilltarët për të mitur dhe këshillat për të mitur. Këshillat për të mitur në gjykatën themelore përbëhen nga gjykatës për të mitur dhe gjykatës porot, ku gjykatësi për të mitur është edhe kryetar i kshillit. Gjykatësin porotë zgjidhen nga rradhët e punonjësve të arsimit-psikologëve, sociologëve dhe personave të tjer të cilët kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjëve. Këshilli për të mitur në gjykatën themelore vendos në shkallë të parë në procedurën për vepra penale si dhe për ankesat kundër vendimeve të gjykatësit për të mitur dhe në raste të tjera të parashikkuara me ligj. Ndërsa, këshillat për të mitur të gjykatës së apelit janë të përbër nga gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatës, vendos për ankesat kundër vendimeve të këshillit për të mitur të gjykatës themelore, si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj.<sup>33</sup>

Gjykata mund të shqiptojë masa ndaj fëmijëve të cilët kanë mbushur moshën që ju takon shqiptimi i masave të tilla, fëmijëve të cilët kanë kryer vepra penale që me ligj parashikohet shqiptimi i masave të caktuara.

Ekzekutimi i masave ka për qëllim arritjen e rezultateve pozitive ndaj fëmijëve. Ekzekutimi i masave bëhet në institucione kompetente ku fëmijët gëzojnë të drejtat dhe obligimet e tyre, stafi profesional apo personeli që trajtonë fëmijun janë të aftësuar dhe disponojnë njohuri nga lëmia e pedagogjise, sociologjisë, psikologjisë si dhe lëmvive të tjera.

Tretmani i fëmijëve në institucione korrektuese zhvillohet ndaras sipas gjinisë së fëmijut, ku meshkujt janë të vendosur në një ambient të vecantë i cili është i ndara dhe nuk ka kontakt me ambientet ku janë të vendosura fëmrat ndaj të cilave është ekzekutuar masë e cektuar.

#### 2.1 Ekzekutimi i masës edukuese të entit Dërgimi fëmiut në ent edukues

Gjykata mund ta dërgoi në institucion edukues fëmijën ndaj të cilit duhet të sigurohet mbikëqyrje e përhershme dhe e përforcuar nga personat profesional (me përgatitje profesionale dhe shkollore për edukator) për edukim, riedukim dhe zhvillim të drejt.

---

<sup>33</sup> Ligji mbi drejtwsin pwr tw mitur, Gazeta zyrtare e RMV-sw, Nr.87/2007, neni 44



Në institucionin edukues fëmija mbetet së paku gjashtë, muaj e më së shumti tri vite. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton zgjatjen e saj por për këtë në mënyr plotësuese vendos në pajtim me nenin 47 paragrafi 2 të këtij ligji.<sup>34</sup>

Masa dërgim në institucion edukues nuk mund të ndërpritet para kalimit të afatit prej gjashtë muajsh, e deri në kalimin e këtij afati mund të zëvendësohet vetëm me dërgim të fëmijës në shtëpi edukuese – përmisuese.<sup>35</sup> Në raste kur pas marrjes së vendimit për shqiptimin e masave të entit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar kur është marrur vendimi, rrethana të cilat do të kishin ndikim në marrjen e vendimit, në këto raste zbatimi i masave mund të ndërpritet ose të zëvendësohet me masë tjetër.

## **2.2 Ekzekutimi i masës edukuese të entit Dërgimi i fëmijut në Shtëpi edukuese-përmirësuese**

Fëmijën ndaj të cilit duhet të zbatohen masa të përhershme dhe të përforcuara për edukim dhe riedukim dhe ndarje të plot të tij nga mjedisi i deri tanishëm, gjykata mund ta dërgoi në shtëpi edukuese- përmirsuese, gjatë vendimarrjes nëse do ta shqiptoj këtë masë gjykata në vecanti do ta marrë parasysh peshën dhe natyrën e veprimit të kryera dhe rrethanat nëse ndaj fëmijës më heret janë shqiptuar masa edukuese ose dënim me burg për fëmijët, në shtëpin edukuese-përmirsuese mbetet së paku një vit e më së shumti pes vitë ose deri në mbushjen e 23 viteve, gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton zgjatjen e saj por për këtë vendos në mënyr plotësuese, gjykata e rishqyrton nevojën për qëndrim në shtëpi edukuese-përmirësuese për çdo vit, me detyr zyrtare, me propozim të prokurorit publik ose me propozim të shtëpisë edukuese- përmirsues.<sup>36</sup>

## **2.3 Kohëzgjatjaligjorepërekzekutimin e masavetëentevendajfëmijëve**

Kohëzgjatja e masave ndaj fëmijëve nuk përcaktohet nëpërmjet gjyqit mirëpo gjyqi vendos në mënyr plotësuese dhe është i obliguar ta rishqyrtoj nevojën e qëndrimit në shtëpi përmirësuese çdo vit.

Sipas ligjit për drejtësin e fëmijëve dërgimi në institucion edukues zgjat më së paku gjashtë muaj, e më së shumti tri vjet. Ndërsa kohëzgjatja e masës dërgim në shtëpi edukuese përmirësuese është më së paku një vit, e më së shumti pesë vite, ose deri në mbushjen e 23

<sup>34</sup> Ligji për drejtësin e fëmijëve, Gazeta zyrtare e RMV-së, Nr.07-4101/1, 2013, neni 45

<sup>35</sup> Po aty, neni 47

<sup>36</sup> Po aty, neni 46, p.1;2;3;4.

viteve, masa dërgim në shtëpi edukuese përmirsuese nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para kalimit të afatit të paraparë me ligj i cili është një vit.

Zgjidhja e këtill ligjore lidhur me kohëzgjatjen e masave të enteve të cilat paraqesin minimumin dhe maksimumin absolut të kohëzgjatjes së masës, de lege lata nuk është në rregull, kjo sepse gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen strikte të masës, por për këtë vendos më vonë, prandaj de lege ferenda gjykata do të duhej të caktojë kohëzgjatjen konkrete të masës me mundësi që me vendim plotësues të shkurtoj afatin e caktuar.<sup>37</sup>

## **2.4 Procesi i riedukimit dhe riintegrit**

Si fillim me termin riedukim kuptojmë edukim të sërishëm pra një person që nuk është i edukuar si duhet që nuk e ka marrë edukatën e mirëfillt apo ka marrë edukatë të gabuar që më vonë e shpreh në jetën e përditshme dhe ato veprime nga edukata e gabuar nuk janë në pajtueshmëri me ligjet, rregullat, parimet e një legjislacioni të caktuar.

Nocioni riedukim dhe riintegrim nënkuptojnë gjendje të personit i cili paraprakisht është i dënuar dhe gjatë qëndrimit në ent në bazë të tretmaneve të caktuara duhet të ndryshojë esencialisht.

Qëllimi i dënimit nuk është ndëshkimi por sipas sistemit modern nënshtrimi i procesit të punës riedukative, që në të ardhmen të mos gabojë, procesi i riedukimit dhe riintegrit zhvillohet gjatë qëndrimit në institucion korrektues qëllimi në të cilin është të arrijë të përgatis fëmijët që në të ardhmen të sillen në pajtim me normat shoqërore morale dhe ligjore në ambientet ku do të jetojnë dhe punojnë. Ky sistem i ekzekutimit të dënimit është në një proces permanent të ndërtimit dhe përsosjes së tij në aspekt që të jetë sa më efikas në arritjen e qëllimit.

Në këtë drejtim kontribut të vacant kanë dhënë rregullat standartet minimale të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur, rregullat evropiane të burgut, konventat evropiane mbi ndalimin e torturës, trajtimin dhe dënimit jo human dhe degradues dhe akte të tjera, në këtë drejtim me trajtimet teorike dhe kërkime empirike vecmas bëhet përpjekje për gjetjen dhe ndërtimin e metodave dhe mjeteve më të përshtashme për arritjen e qëllimit të riintegrit dhe riedukimit të personave të dënuar.<sup>38</sup>

---

<sup>37</sup> Ahmedi Arifi B. 2019, Dispens/Delikuenca e të miturve, Tetovë, fq.62

<sup>38</sup> Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq.145

Përgjegjësin për procesin e riedukimit dhe riintegritit e mbanë personeli i entit për shërbime të ndryshme në institucione përgjegjësia e personelit është që një fëmijë përsëri të riedukohet dhe risocializohet dhe riintegrohet në shoqëri, ku kërkohet një ndryshim rrënjësor që fëmijët të pësojnë transformim si në sjellje ashtu edhe në bindjet e tij lidhur me veprën që e ka kryer.

Qëllimi i procesit të riedukimit dhe riintegritit është që sjellja e fëmijëve të ndryshojë jo nga frika dhe kërcënimi i ndëshkimit por nga bindja se kjo mënyrë është më e mira në interes të jetës dhe mirëqenjes së tij. Një ndër pikat kyqe të periudhës kur fëmiju është në institucion korrektues është që fëmiju ti pranojë obligimet e entit dhe ti respektoj ato dhe të konsideroj se janë në të mirë të tij.

Shume her fëmijët që janë shkakuar të veprave penale janë product i gjendjes psikike dhe shpirtërore të personalitetit të tij, andaj gjatë procesit të riedukimit dhe riintegritit duhet pasur parasysh se mosmarveshjet dhe problemet nuk vijnë gjithmonë nga mjedisi që i rëthon.

Riedukimi dhe riintegrimi që të jenë më të sukseshëm duhet që fëmijët të harmonizojnë kërkesat motivet dhe dëshirat e tij personale me raportet e mjedisit me normat dhe rregullat ligjore që vlejnë në shoqëri.

Në këtë mënyrë gjasat për përsëritjen e sjelljeve kriminale të të dënuarit janë shumë të vogla, me qëllim të riintegritit të plotë të personave të dënuar sistemi modern i ekzekutimit të dënimit me burgim në pajtim me rregullat standarte minimale të OKB-së dhe me idenë e shkollave dhe lëvizjeve humanitare, është interesuar që të krijojë disa parkushte themelore në këtë drejtim, ato parakushte kanë të bëjnë me organizimin në një tretmani më adekuat të riintegritit të personave të dënuar, ai është i mundshëm vetëm nëse bëhet studim dhe observim i personalitetit dhe personit të dënuar, individualizimi i tretmanit të të dënuarit klasifikimi i të dënuarve klasifikimi i institucioneve korrektuese dhe nëse zbatohen në mënyrë permanente ndihma postpenale e personave të dënuar.<sup>39</sup>

Procesi i riedukimit dhe riintegritit arrihet me angazhim të veprimeve edukuese, angazhim në aktivitet për aftësimin e tyre profesional, qëllimi i këtyre veprimeve është që të orientohet gjenjda dhe sjellja e fëmijut në drejtim pozitiv gjatë kohës që gjendet në institucion korrektues, ku njëkohësisht mënjanojnë shprehjet dhe sjelljet negative të cilat i ka pasur kur ka ardhur në ent.

---

<sup>39</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 147

## 2.5 Individualizimi i tretmanit penitensiar si kusht për riedukim të fëmijëve

Me individualizim të tretmanit penitensiar të personave të dënuar nënkuptohet përshtatje e metodave dhe mjeteve të ndikimit të personalitetit të tyre, kjo do të thotë se mjetet, metodat, masat e veprimit të cilat ndërmiren nga ana e personelit të institucionit duhet tu përshtaten vetive dhe cilësive psikike, sociale dhe kulturore të personave të dënuar, është e ditur se të gjitha masat dhe metodat e tretmanit nuk ndikojnë njësoj te të gjithë fëmijët e dënuar.<sup>40</sup>

Disa masa dhe metoda kanë efekte dhe ndikim më të vogël, në disa raste disa masa dhe metoda që aplikohen, nëse nuk iu janë përshtatur vetive të personalitetit të të dënuarit, mund të sjellin edhe efekte negative, për këtë arsye, individualizimi i masave, mjeteve dhe metodave të tretmanit të personave të dënuar është parakusht “*contitio sine qua non*”, si thekson një autor për riedukimin dhe riintegrimin e suksesshëm, për tu realizuar dhe zbatuar me sukses realizohet me individualizimin e tretmanit ndaj personave të dënuar, është e domosdoshme që të ndërmeren disa veprime dhe masa konkrete nga ana e personelit të institucioneve korrektuese, këto masa kanë të bëjnë me studimin, observimin dhe njohjen e personalitetit të të dënuarve.<sup>41</sup>

Cdo fëmijë i cili i është nënshtruar tretmanit penitensiar është analizuar personaliteti i tij dhe zhvillimi i tretmanit është bazuar sipas kësaj analize me qëllim që të jetë sa më i efekshëm, si dhe masat dhe veprimet që do të ndërmeren gjatë tretmanit të përshtatet personalitetit të fëmijës.

Qëllimi i tretmanit penitensiar është që të ndryshohet rënjësisht personaliteti i fëmijës, qëndrimet e tij, sjelljet, pikëpamjet të cilët e kanë shtyer fëmijën të kryej veprë penale, si dhe cdo veprim tjetër që ka qënë i kundërligjshëm, pra individualizimi i tretmanit penitensiar është njëri ndër proceset më të rëndësishëm për riedukimin e fëmijëve.

Ndryshimi pozitiv dhe arritja me sukses e riedukimit dhe riintegrimi të fëmijëve në shoqëri nëpërmjet tretmanit të individualizuar penitensiar kalon nëpër disa faza të cilat janë: njohja e fëmijëve të dënuar, njohja e vetive psikike, cilësit e tij elementare deri te njohja më e thell e qëndrimeve, vizioni i tij, mendimet dhe idet e tij si dhe vetit e karakterit të tij.

---

<sup>40</sup> Halili R. 2014, Penlogjia, Prishtinë, fq. 150

<sup>41</sup> Po aty, fq. 150

## 2.6 Institucionet edukuese – përmirësuese për ekzekutimin e masave të enteve për fëmijë

Enti edukues-korrektues-Tetovë është institucion i llojit gjysmë të hapur në të cilin realizohet masa edukuese-dërgim në entin edukues-korrektues të personave të gjinisë mashkullore, të moshës prej 14 deri më 23 vjet, kryrës të veprave penale, të cilëve me aktvendim të gjykatës u është shqiptuar kjo masë. Duke filluar prej datës 14.09.2015 Enti edukues-korrektues-Tetovë funksionon në objekt në përbërje të Institucionit ndëshkues-korrektues Burgu-Ohër. Objekti i institucionit daton prej vitit 1959/60 si pjesë e stacionit policor, ndërsa në vitin 1962/63 ndahet si institucion i 7 veçantë ndëshkues-korrektues në të cilin dërgohen persona të rinj dhe persona të mitur meshkuj të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burg për të mitur, si dhe persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është përcaktuar paraburgimi nga gjykatat themelore rajonale: Dibër, Ohër dhe Strugë, përveç paraburgimit të përcaktuar për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me burg prej më pak se 10 vjet ose burg i përjetshëm

Ky Institucion ndëshkues- korrektues-Ohër është në afërsi të Stacionit policor Ohër, i rrethuar me objekte private për banim dhe objekte afariste. Pjesa në të cilën janë vendosur fëmijët të cilët vuajnë masën e entit është në objektin ku janë të vendosur edhe personat e dënuar me dënim me burg për të mitur, me ç'rast fëmijët e entit edukues-korrektues janë vendosur në katin e parë në pjesën e përparme të institucionit, e cila është e ndarë nga pjesa e burgut vetëm me një derë. Obori i institucionit ndëshkues-korrektues është i ndarë në dy pjesë me gardh të metaltë, një pjesë e oborrit është për fëmijët e EEK-së, ndërsa pjesa tjetër për fëmijët e burgut. Oborin e shfrytëzojnë për aktivitete sportive, lëvizje në ajër të pastër dhe i njëjti mund të sfrytëzohet vetëm në kushte të volitshme atmosferike, pasi është nën qiell të hapur, përkatësisht nuk është i mbuluar. Edhe pse sipas autoriteteve të këtij institucioni bëhen përpjekje që fëmijët të ndahen nga personat e tjerë, nga inspektimi dhe biseda me fëmijët u konstatua se komunikimi dhe kontakti ndërmjet fëmijëve dhe personave të dënuar nuk mund të pengohet në tërësi.<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> Po aty

### Kapitulli III

#### 3. MJETET DHE METODAT E TRETMANIT TË FËMIJËVE TË GJYKUAR

Mjetet dhe metodat që përdoren për tretman të fëmijëve të gjykuar kanë për qëllim arritjen sa më efektive të qëllimit të gjyqimit, realizimin e procesit të riedukimit, risocializimit dhe riintegritimit të fëmijëve të gjykuar. Mjetet dhe metodat për tretman që përdoren nëpër institucione korrektuese dhe edukative përmisuese, ku nëpërmjet formave të ndryshme tentohet arritja e rezultateve sa më të mira në procesin e riedukimit dhe riintegritimit të fëmijut. Mjetet dhe metodat janë proces i paramenduar që më parë për aritjen e rezultateve sa më të mira të fëmijët duke i studiuar vetitë e fëmijëve.

Trajtimi i mjeteve dhe metodave të tretmanit të fëmijëve është në pajtueshmëri me parimet themelore të përfshira në rregullat Evropiane për të drejtat e fëmijëve të cilët kanë kryer veprë penale. Mjetet dhe metodat e tretmanit mund të shqiptohen fëmijut i cili ka kryer veprë që me ligj përcaktohet si veprë penale apo veprim i kundërligjshëm, për mjetet dhe metodat e tretmanit të fëmijëve të dënuar do të merret parasysh mosha e fëmijut, shkalla e zhvillimit të tij shpirtëror, vetitë e tij psikike, arsimit i deritanishëm, arsyet që e kanë shtyrë të kryej veprën, rethi ku ka jetuar, pesha e kryerjes së veprës, nëse kundër fëmijut ndonjëherë është ushtruar ndonjë tretman i caktuar<sup>43</sup>.

Për fat të keq në vendin tonë mjetet dhe metodat për tretmanin e fëmijëve nuk janë në nivelin e duhur, duke filluar nga mungesa e edukatorëve, mjekut, mungesa e hapsirave zbavitëse dhe sportive, mungesa e bibliotekave, për të cilat do të sqarojmë gjatë pikave në vijim, duke u ndalur në secilin mjet dhe metodë që me dispozita ligjore duhet të ketë secili ent që ka për funksion riedukimin dhe riintegrimin e fëmijëve në shoqëri.

Mjetet dhe metodat për tretmanin e fëmijëve të dënuar janë<sup>44</sup>:

- Puna e fëmijëve të sanksionuar;
- Puna e edukatorit;
- Puna e psikologut;
- Puna e mjekut;
- Arsimimi i fëmijëve të dënuar;

<sup>43</sup> Recommendation CM/Rec (2008)11 of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions and measures, 5.11A.2008, Council of Europe

<sup>44</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 176

- Aktivitetet zbavitëse dhe sportive;
- Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë.

### 3.1 Puna e fëmijëve të sanksionuar

Një ndër metodat më të fuqishme për realizmin e procesit të riintegrit konsiderohet puna dhe angazhimi i fëmiut në ent, qëllimi dhe karakteri i punës ka qenë i llojllojshëm por gjithmonë me orientime pozitive, gjithmonë ka qenë i varur dhe i bazuar në dënimin që e ka pasur fëmiu.

Puna paraqitet si mjet pozitiv për përmirësimin e fëmiut ajo është e detyrueshme atëher kur personeli i burgut do ta shoh si të arsyeshme, puna është proces që rjedh nëpër faza të ndryshme të fëmiu, ku në fillim nuk pritët ndryshim i madh apo rënjësor i karakterit të tij, mirëpo me kalimin e kohës edhe natyra e punës do të ndryshojë ku nëpërmjet këtij trajtimi, mjeti dhe metode do të tentohet një tretman i sukseshëm dhe pozitiv, sipas statistikave është një ndër metodat më efikase.

Puna në fillim ka karakter shtërngues që me kalimin e kohës ndryshon qasje dhe fillon të transformohet në mjet nëpërmjet të cilit do të bëhet përpjekje fëmiu të aftësohet për jetën në të ardhmen, karakteristikë e punës të fëmiu është që të krijohen shprehi për punë, për krijimin e bindjeve dhe shprehive të reja për ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të mëparshme të fëmiut të dënuar<sup>45</sup>.

Tretmani nëpërmjet punës konsiderohet edhe si misioni për ti bindur fëmijët se me punë të ndershme mund të sigurohet jetë e pavarur dhe dinjitoze në shoqëri, qëllimi i këtij tretmani është që fëmijët të aftësohen me përfitimin e zantave, mjeshteri dhe profesione të ndryshme të cilat pa pengesa mund të garantojnë vazhdimin e jetës dhe ekzistencës në liri, në një formë sigurohet egzistenca materiale dhe sociale si dhe adaptimi për një jetë normale.

Puna mund të jetë edhe e karakterit të dobishëm në ekonominë shtetërore apo shoqërore, në aspektin etik dhe social duhet të jetë punë që bëhet në liri. Në fillim e cekëm që puna do kalojë nëpër disa faza ku lloji i punës do të jetë në bazë të karakteristikave të personalitetit të fëmiut dhe llojit të dënimit që ka, duke u bazuar në këtë teori do ti jepet hapësirë fëmiut që të

<sup>45</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

shpreh dëshirën e tij për llojin e punës, ku do të shiqohen aftësit e tij për punë të caktuar, mundësitë dhe angazhimin e tij<sup>46</sup>.

Puna e fëmiut garantohet me Deklaratën e përgjithsme mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, për arsye se e drejta e punës është e drejtë elementare njërzore që njeriut i siguron ekzistencën dhe për këtë arsye nuk duhet ti mohohet askujt e as personave të dënuar e në këtë rast fëmijëve.

Nëpërmjet punës si e drejtë që u takon fëmijëve institucioni korrektues angazhohet që të bëjë ngritje profesionale të fëmijëve dhe përgaditje që pa vështirësi të vazhdojë jetën në liri, ky është edhe qëllimi i kësaj metode dhe këtij mjeti të punës për fëmijë sipas sistemit modern dhe bashkëkohor.

Arsimimi dhe përgatitja profesionale planifikohet dhe programohet me kyçjen e ekspertëve të profesioneve të ndryshme, fëmijët e gjykuar që do të ndjekin punë në profesione të caktuara në përfundim të këtij programi do të paisen me vërtetime, certifikata, diploma, dëftesa dhe dëshmi tjera që do të vërtetojnë aftësinë e tyre për punë dhe që do të pranohen pa problem në liri, pas përfundimit të dënimit.

Institucioni korrektues është i detyruar që të gjithë fëmijëve tu mundësoj kushte të njejta për punë, mbrojtje në punë, dhe të mundësoj krijimin e të gjitha kushteve që do të ishin të pranishme sikur fëmiu të ishte në liri, puna nuk ka për qëllim fitimet materiale po qëllimi i kësaj metode është aftësimi profesional për jetë të pavarur në liri<sup>47</sup>.

### **3.2 Puna e edukatorit**

Një ndër metodat më të rëndësishme të tretmanit në ente edukuese përmirësuese është puna e edukatorit, puna e edukatorit është e komplikuar e cila përfshin një punë me aktivitete të shumta dhe procese të ndryshme në raport me të dënuarin. Puna e edukatorit lidhet me nevojën e njohjes së plotë të personalitetit të të dënuarit me përcjelljen e punës dhe sjelljeve të tij në ent, bisedat, këshillimet, arsimimin dhe orientimin personal, pra puna e edukatorit qëndron në shumë veprime dhe aktivitete të planifikuara dhe të programuara që më parë<sup>48</sup>.

Puna e edukatorit bazohet në njohuritë që ka edukatori për personalitetin e të dënuarit, pra si fillim hulumtohet në identitetin dhe personalitetin e fëmiut, me njohjen e dokumentacionit të plotë nga gjykata lidhur me veprën penale, me qëllim që të studiojë dosjen dhe dokumentacionin

<sup>46</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

<sup>47</sup> Po aty

<sup>48</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177



penologjik të të dënuarit, të analizojë sjelljet dhe qëndrimet që fëmiu i ka pasaur, të dhëna mbi familjen e tij, të dhëna mbi aktivitetet që i ka kryer në liri si dhe vlersime dhe konstatime të tjera për vetitë subjektive dhe individuale të personalitetit të tij. Edukatori nëpërmjet aktiviteteve të kryera që u potencuan më lartë duhet që të arrijë të përcaktojë dhe konkretizoj gjendjen psikike dhe shpirtërore të fëmiut, nëpërmjet këtyre përcaktimeve ai do të veprojë në mënyrën më të mirë të mundshme që të arrije në mënyrë sa më efikase riedukimin dhe riintegrimin e fëmiut të dënuar.

Shumë ente nuk kanë qendra për studim dhe observim të personave të dënuar, nuk kanë kuadër të aftë për hartimin e programeve të tretmanit dhe kësisoj, shpeshherë, kërkesat e tilla mund të shtrohen vetëm si kërkesa teorike, po ashtu shpeshherë, ndodh që raporti në mes edukatorit dhe numrit të personave të dënuar të jetë në disproporcion, në disa ente, në të cilat janë grumbulluar një numër i madh i personave të dënuar e nga ana tjetër ka pak edukatorë dhe pedagogë të punësaur, puna e edukatorëve dhe pedagogëve është e kufizuar, sepse atyre për një edukator vjen një numër i madh personash të dënuar, çka e vështirëson mundësinë e punës të suksesshme individuale të edukatorit apo pedagogut<sup>49</sup>.

Rruga drejt riedukimit dhe riintegrit të fëmiut të dënuar nuk kalon pa u bazuar në punën e edukatorit, pasi fëmiu do të udhëhiqet dhe do të orientohe në atë rrugë nëpërmjet punës së edukatorit, nëpërmjet kontakteve me edukatorin fëmiu do të arrijë të finalizojë me sukses riintegrimin, ndryshimin e sjlljeve dhe qëndrimeve, krijimin e shprehive të reja pozitive, të cilat do ti shfrytëzojë në liri, shprehi të cilat do të imponohen në shumë raste nga edukatori.

Rëndësi të madhe ka mënyra se si do të bëhet njohja dhe vazhdimi i kontaktit të edukatorit me fëmiun e dënuar, si do të jetë njohja e tyre, në këto raste edukatori duhet të ketë kujdes të vecantë që të arrijë të komunikojë me fëmiun në mënyra të ndryshme që të fitohet besimi te fëmiu se edukatori është njeriu me të cilin mund të shoqërohet në ent, të fillojë të shpreh mendimet e veta lirshëm, që nëpërmjet të dhënave që do të krijohen të arihet procesi i riintegrit.

Puna e edukatorit llogaritet si mjeshtëri e veçantë me anë të së cilës do të bind fëmiun se ai është personi i cili po kujdeset për ti ndihmuar atij dhe është në të mirën e fëmiut, pasi që fëmijët janë të rezervuar ndaj çdo të punësuarit në ent dhe nuk pranojnë çfardo kontakti me personelin e entit, është edukatori ai i cili duhet të ndryshojë këtë gjendje që të hapë botën

---

<sup>49</sup> S. Surbatovic etj, Individualni rad vaspitaca osudjenim licima, Penoloski Flasniki, nr.6-7, 1985, fq. 44-45

psiqike dhe shpirtërore të fëmijut, hapat drejt arritjes pozitive të procesit të tretmanit të fëmijëve në ent fillojnë nga edukatori i cili nëse do të arrije të vëndoje kontaktet e para të shëndosha të krijojë një besim reciprok atëherë tretmani do të jetë më i suksesshëm, në këto raste kur krijohet besim nga ana e fëmijut ata vetë kërkojnë biseda me edukatorët e cila paraqet shenjë që procesi është në rrugën e duhur.

Disa nga metodat që përdorin edukatorët me fëmijët e dënuar janë<sup>50</sup>:

- metoda e bindjes;
- metoda e krijimit të shprehive;
- metoda e nxitjes;
- metoda e premtimit, dhuratave dhe shpërblimeve;
- metoda e shterngimit dhe ndëshkimit.

**Metoda e bindjes** – qëndron në aktivitetin e edukatorit dhe punëtorëve të tjerë penitensiarë që personat e dënuar ti bindin për sjelljet, qëndrimet dhe veprimet e ndryshme që janë të dëmshme dhe negative për pozitën e tyre dhe shtrojnë nevojën që ai, këto veprime dhe sjellje, duhet ti ndryshojë në kahje tjetër, kjo metodë, veçmas ka të bëjë me insistimin e edukatorit që ti bindë të dënuarit ti respektojnë rregullat e rendit shtëpiak, obligimet dhe detyrimet tjera të cilat parashtrohen para tyre gjatë qëndrimit në ent, të bindësh personat e dënuar, do të thotë të bësh përpjekje permanente dhe biseda të përditshme me qëllim të krijimit të një gjykimi tjetër, një vlerësim të ri, një raport fare tjetër lidhur me disa vlera dhe të mira të caktuara, bindja arrihet me anë të shpjegimit të drejtë dhe objektiv të ecurive dhe raporteve që janë në interes të përmirësimit të personave të dënuar, edukatori dhe pedagogu, personave të dënuar u ofrojnë shpjegime konkrete lidhur me atë se çka është e mirë, çka është e vlefshme, çka është e drejtë dhe e favorshme për pozitën e tyre në ent, përvec shpjegimit, për krijimin e bindjes, rol me rëndësi në këtë drejtim luan edhe paraqitje e shembujve konkretë nga jeta e përditshme, si brenda në ent, ashtu edhe jashtë institucionit, këta shembuj të cilët u prezantohen personave të dënuar, mund të jenë me karakter dhe domethënie pozitive por edhe negative, është me rëndësi

---

<sup>50</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 178

që gjatë paraqitjes dhe prezantimit të shembujve personat e dënuar të kenë mundësi të zgjedhin vetë dhe të deklarohen se cilët shembuj janë me tipare negativë e cilët të favorshëm.<sup>51</sup>

**Metodat e krijimit të shprehive** – te fëmijët e dënuar qëllim kryesor është krijimi i shprehive positive dhe të gjitha shprehive që do ti ndihmojnë në liri, që të arrijmë që te fëmijët të instalojmë krijimin e shprehive të caktuara pozitive duhet që vazhdimisht ti përsërisim ato në ent, si shprehi të cilat tentohet të mësohen dhe aftësohen në ent janë që fëmiju të mësohet të kryejë aktivitete në të mirë të shoqërisë dhe në këtë mënyrë të çrrënjosen aktivitetet dhe shprehitë e mëparshme negative, shprehitë për higjienë personale, për higjienë të ambientit, për aftësim profesional për mirësjellje dhe qëndrim korrekt ndaj të tjerëve etj.

**Metoda e nxitjes** – qëllimi i kësaj metode është që të nxitë fëmijun të zhvillojë aktivitete të caktuara positive në të mirë të tij, të shfaq interes, vullnet, dëshira për veprime pozitive, metoda e nxitjes vjen në shprehje më së shpeshti tek fëmijët të cilët janë më pasiv, të ndrojtur, pa vullnet dhe të painteresuar, mënyrat të cilat përdoren për nxitje janë: premtime të ndryshme, lëvdatat, dhurata, notimi , shpërblimi etj.

**Metoda e premtimit, dhuratave dhe shpërblimeve në mënyrë publike** – është një metodë me anë të së cilës do të nxiten aktivitetet të dobishme për fëmijët në interes të tyre, mirëpo përdorimi i kësaj metode duhet të jetë me kujdes të madh që të mos shkojë në skajshmëri që të mos shkaktohen paknaqësi në mes të fëmijëve pasi që jo rallë here ka ndodhur të shfaqen edhe veti negative gjatë trajtimit të kësaj metode, xhelozia, urejtje, egoizëm, agresivitet, mostolerancë.

**Metoda e shtërngimit dhe ndëshkimit** –aplikohet nga ana edukatorit dhe pedagogut kjo metodë vjen në shprehje në rastet kur metodat tjera nuk janë efektive aq sa janë menduar, këto metoda ndërmiren ndaj fëmijëve të cilët nuk janë të ndërgjegjshëm, nuk respektojnë rregullat e entit, nuk u përmbahen rregullave të rendit shtëpiak. Qëllimi i kësaj mase është që fëmijët të kuptojnë se sjellje të caktuara nuk janë të mira dhe janë në dëm të tyre dhe shoqërisë dhe ti anashkalojnë të njejtat. Si mjete që përdoren për këtë metodë janë: qortimi, vërejtja, kontrolli, mbikëqyrja, ndalesa të ndryshme, detyrim për kryerje të veprimeve të caktuara etj.

---

<sup>51</sup> A.Sobotincic: Uloga pojedinih kategorija radnika u KPD u odgojnom procesu resocijalizacije, botuar në Penlogjia, nr 1.197, fq. 4-5

### 3.3 Puna e psikologut

Psikologu luan rol të rëndësishëm për tretmanin e fëmijëve, ai bën klasifikimin e tyre në grupe dhe nëngrupe duke u bazuar në karakteret e tyre dhe aftësitë e tyre, ai u ndihmon fëmijëve që të përshtaten në ent, si punë dhe veprime që i përdor psikologu lidhur me tretmanin e fëmijëve janë: zbatimi i testeve të ndryshme, intervistave, bisedave, testimeve të ndryshme etj.

Fëmijët zakonisht nuk janë të gatshëm që të i përgjigjen kërkesave të psikologut si testet, intervistat dhe bisedat e ndryshme, pasi që psikologun e konsiderojnë si “armik” të tyre, mirëpo detyrë e psikologut është që ti bindë ata se këto veprime janë për të mirën e tyre dhe kanë për qëllim që ti ndihmojnë ata dhe jo tu shkaktojnë të këqija apo ti dëmtojnë.

Sipas koncepteve penologjike bashkëkohore, në teorinë penologjike, megjithë vështirësitë e caktuara, psikologu ka rëndësi dhe ndikim të madh në procesin e riintegritit të personave të dënuar, me njohuritë dhe angazhimin e vet profesional, ai ndihmon shumë të dënuarit që ti përshtaten jetës dhe punës në mjedisin korrektues, psikologu ka për detyrë që të ndikojë edhe në personelin e institucioni që ai të kycet në tretmanin bashkëkohor të personave të dënuar<sup>52</sup>.

### 3.4 Puna e mjekut

Mjeku është specialist i cili kujdeset për fëmijët në ent, pozita e mjekut ka rol të rëndësishëm në tretmanin e fëmijëve për shkak se konsiderohet se fëmijët e burgosur kanë besim të madh te mjeku, gjë që mundëson krijimin e kontakteve më të afërta me fëmijët e dënuar, situata e cila shfrytëzohet nga mjekët që të ndikojë pozitivisht dhe të krijohet mundësi për ndikim pozitiv në sjellejet dhe qëndrimet e tyre në ent, jo rallë herë është dëshmuar puna efektive e mjekut. Nga afërsia që në bazë të praktikës krijohet në mes mjekut dhe fëmijëve është shumë e shpeshtë që fëmijët të rëfelen për çështje të ndryshme, probleme që pjesa tjetër e personelit të burgut nuk i dine, si dhe probleme të tjere që e rrethojnë apo e kan shqetësuar jashte entit.

Enti është i obliguar me ligj që të mbajë dosje personale shëndetësore për të gjithë fëmijët të vendosur në ent dosje të cilat duhet të ruhen dhe të udhëhiqen me lista për evidenca ku do të jenë të evidentuar gjendjet shëndetësore të fëmijëve poashtu do të shënohet të gjitha intervenimet që do të ndërmiren për shëndetin e fëmijut, medikamentet që shfrytëzohen në institucion duhet të jenë në vend të sigurt.

---

<sup>52</sup> Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 184

Në entin edukues korrektues në Ohër nuk ka mjek i cili gjendet në hapësirat e parapara dhe sipas ligjit, duke pasur parasysh rëndësinë e mjekut në procesin e risocializimit si një nga metodat më të suksesshme të afrimit me fëmijë dhe krijimin e besimit mes tyre, në vendin tonë kjo metodë nuk respektohet ashtu si është paraparë me ligj, mjeku thirret vetëm në rast nevojë.

Personave të gjykuar dhe të paraburgosur duhet që të ju sigurohet ndihmë e nevojshme mjekësore, sipas rregullave nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor<sup>53</sup>.

Punonjësit shëndetësor, të punësuarit në institucionet shëndetësore publike, që kryejnë mbrojtjen primare shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore, që në zonën në të cilin gjendet qendra e institucionit, japin shërbime shëndetësore personave të gjykuar dhe të paraburgosur, shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore të këtyre personave në institucion bien në barë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë<sup>54</sup>.

Mjekët duhet të jenë të vetëdishëm për rethanat të cilat krijohen nga raporti i tyre i afërt me fëmijët dhe të njëjtat duhet ti shfrytëzojnë me qëllime pozitive, me qëllim që procesi i riedukimit dhe riintegritit të fëmijëve të jete me efektiv, duke pasur parasysh rëndësinë e mjekut në ent, mendimet dhe propozimet e tij kanë rëndësi të vecantë nga pjesa tjetër e personelit të burgut.

Mjeku duhet të jetë shumë i kujdesshëm në raport me fëmijët dhe të mos keqpërdorë besim e tyre të jetë bashkëpunues me të punësuarit e tjere, për arsye se nga përvoja e këtyre praktikave kur mjeku ka keqpërdorur besim e fëmijëve pasojat kanë qënë të rënda dhe negative për realizim e qëllimit të dënimit me burg.

Nga praktika penitensiare theksohet se personat e dënuar i besojnë mjekut dhe psikiatrit dhe rrëfenë disa çështje, probleme dhe preokupime intime të cilat personeli tjetër i institucionit nuk mund ti hetojë dhe ti dijë, këto rrethana, punëtorët shëndetësor duhet ti shfrytëzojnë, me qëllim të aplikimit të mjeteve dhe metodave më të përshtatshme për rehabilitimin dhe riedukimin e personave të dënuar, nga ana tjetër, vecmas insistohet që ky besim reciprok të mos keqpërdoret, sepse, në raste të tilla, pasojat janë të rënda dhe negative për realizimin e procesit të riedukimit dhe riintegritit<sup>55</sup>.

---

<sup>53</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 170/30, neni 20

<sup>54</sup> Poaty, neni 20 paragrafi 2

<sup>55</sup> S.Nikolic: Uloga zdravstvenih radnika u procesu resocijalizacije lica lisenih slobode, Penologija, nr.1, 1975, fq.56-57

### 3.5 Arsimi i fëmijëve të dënuar

Fëmijët të cilët janë të distancuar nga procesi arsimor kanë më shumë mundësi të kryejnë vepra të kundërligjshme që me ligj janë të dënuara dhe të përcaktuara si vepra penale, në krahasim me fëmijët të cilët ndjekin në mënyrë të rregullt procesin arsimor.

Në burg për fëmijë përpos metodave që përmenden për procesin e riedukimit dhe riintegritit aplikohet edhe arsimimi si metodë e cila do të përfshihet në metodat me të cilat kryhet tretmani në burg për riedukim dhe riintegrim të fëmijëve pasi pa arsimin nuk mund të paramendohet një tretman i suksesshëm, me dominimin e idesë për arsimin, arsimimi bëhet një ndër metodat të domosdoshme të cilat shfrytëzohen në procesin e riedukimit dhe konsiderohet si metodë e rëndësishme që do të mundësojë aritjen e qëllimit.

Qëllimi i arsimimit të fëmijëve të dënuar është që ato të mos ngelin prapa nga moshatarët e tyre në këtë proces, sipas ligjit për fëmijë në vendin tonë të gjithë fëmijët kanë të drejtë të ndjekin procesin arsimor edhe në qoftë se janë të dënuar, duke pasur parasysh se në këtë mënyrë do të arihet përgatija e fëmijëve edhe për jetën në vazhdimsi.

Për rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të dënuar janë parqitur mendime të ndryshme ku është vërtetuar rëndësia e arsimimit poashtu edhe organizata, shoqata dhe asociacione ndërkombëtaree kanë konsideruar si njëri ndër faktorët më të rëndësishëm për riedukim të fëmijëve të dënuar është arsimimi i tyre.

Në këtë drejtim janë të njohura edhe mendimet dhe pikëpamjet Enriko Ferit, përfaqëuesit eminent të shkollës poiztiviste italiane, ai ishte kundër torturave ndaj të dënuarve dhe insistonte që në procesin e tretmanit të aplikohet si metodë arsimimi dhe shkollimi i personave të dënuar, sidomos emancipimi i tyre kulturor edhe shumë mendimtarë tjerë kishin bindje se shkaki i krimi qëndron në mosdije, primitivizëm dhe nivel të ulët të përgaditjes arsimore dhe profesionale, shkrimtari i madh francez, Viktor Ygo duke dashur të theksojë rëndësinë e arsimimit dhe shkollimit në pengimin e kriminalitetit ka thënë: “Hapja e një shkolle, do të thotë mbyllja e një burgu”<sup>56</sup>.

Në institucione korrektuese të cilat e kanë përqafuar sistemin modern dhe bashkëkohor, mbretëron mendimi se arsimimi dhe shkollimi i personave të dënuar duhet të përgaditet dhe të organizohet me përgjegjësi dhe kujdes të madh, personave të dënuar sipas këtij sistemi, duhet tu mundësohet shkollimi dhe arsimimi në të gjitha nivelet, e sidomos atyre personave të cilët

---

<sup>56</sup> D.Atanackovic, vep.e cit. fq. 225-227

tregojnë talent dhe interesim të vecantë në këtë drejtim. Për arritjen e nivelit dhe shkallës së arsimimit e shkollimit si dhe aftësive profesionale personave të dënuar duhet tu lëshohen dëftesa, diploma dhe certifikata të cilat vlejnë edhe në liri, kjo rrethanë ka rëndësi të madhe për shkak të mundësisë që personat e dënuar, të kycen pa probleme në të gjitha rrjedhat e shkollimit, arsimimit dhe përgatitjes profesionale. Nëpër ente ndëshkimore-përmirësuese, varësisht prej shteteve, kushteve dhe rrethanave materiale kadrovike, organizohen shkolla të ndryshme me karaktertë përgjithshëm ose special, në këtë drejtim, mund të organizohen shkolla ekonomike, bujqësore, teknike, shkollat e mjeshtërive dhe zanateve të ndryshme etj, mësimi në këto shkolla vecmas përcillet me mësimin praktik, cka ka rëndësi të vecantë për përgaditje më të gjithanëshme të personave të dënuar<sup>57</sup>.

Të gjitha rethanat që janë pjese e arsimimit si proces në tretmanin e fëmijëve të dënuar kuptohet se janë favorizuese për fëmijët me qëllim që këto tipare që fëmijët do ti fitojnë gjatë periudhës në të cilën janë të privuar nga liria të mund ti shfrytëzojnë në pjesën tjetër të jetës, përpos që të dënuarit do të jenë më të gatshëm për jetën në vazhdim, ata do të shperblehen në forma të ndryshme në rastet kur do të kenë rezultate të mira në procesin e arsimimit, procesi i arsimimit ka për qëllim aritjen e rezultateve pozitive në riedukimin dhe riintegrimin e plotë të tyre, veçanërisht në vendet më të zhvilluara metoda e arsimimit në ente përmirësuese ka dhënë rezultate befasuese për fëmijët, gjë që nuk po respektohet në nivelin e duhur në vendin tonë.

---

<sup>57</sup> Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 195

### 3.6 Aktivitetet zbavitëse dhe sportive

Aktivitetet zbavitëse dhe sportive janë të pranishme në të gjitha entet korektuese duke marrë parasysh tretmanet tjera që bëhen për riedukim dhe riintegrim të fëmijëve aktivitetet zbavitëse dhe sportive janë të rëndësishme së njëjt për këtë proces, secili ent organizon aktivitete sportive qëllimi i të cilave është që fëmijët përvec metodave tjera të kenë kohë të angazhohen edhe në aktivitete sportive, fëmijët shfaqin interes për tu bërë pjesë e aktiviteteve sportive, në ente organizohen gara të ndryshme sportive, poashtu edhe aktivitete kulturore-zbavitëse organizohen në entet korektuese të cilat kanë qëllimin e njëjtë drejt realizimit pozitiv të procesit të riintegritit dhe riedukimit.

Të gjithë entet duhet të disponojnë salla të leximit biblioteka poashtu entet duhet të nxjerrin revista të ndryshme ku do të vlerësohen të ariturat e të dënuarve, rezultatet e tyre të shfaqen në ato revista, punime të ndryshme të cilat do të kenë autorë fëmijët e dënuar, revistë e cila do të ketë përmbajtjen nga jeta e fëmijëve të dënuar dhe reth procesit që ata po e kalojnë në ent, qëllimi i të gjitha aktiviteteve qofshin zbavitëse apo sportive është që të ngjallin interes nga shumica e të dënuarve që të fillojnë të angazhohen së bashku pasi me fillimin e aktiviteteve të reja ata do të largohen apo këto aktivitete do të ndikojnë që tek fëmijët të krijohen shprehje të reja dhe të largohen nga shprehjet negative.

Aktivitetet sportive kryhen gjatë kohës së lirë të fëmijëve të dënuar, qëllimi i kësaj është që në kohën e lirë fëmijët të mos kenë aq shumë hapsirë që të mendojnë për veprime negative dhe të ndikohen negativisht gjatë qëndrimit në ent mirëpo nëpërmjet këtyre aktiviteteve ata të shpenzojnë kohën e lirë që të mund sa më shpejt të largohen nga shprehjet e këqija.

Nëpër institucionet korektuese organizohen gara të ndryshme në sporte të ndryshme me qëllim që të dënuarit të adaptohen në funksionim kolektiv të bashkëpunojnë në frymë kolektive, të veprojnë të bashkuar, të kontrollojnë agresionin dhe nervozizmin, pasi në gara paraqiten agresione të ndryshme që në ent do dilnin në pah gjatë këtyre garave dhe personave tjerë në ent do tu vinin në shërbim këto veti apo momente kur te fëmijët do të paraqiteshin shenja të agresionit që në mënyrë sa më të mirë të mundshme ti evitojnë dhe të instalojnë frymë tjetër mënyre tjetër të funksionimit me qëllim riedukimit dhe risocializimit apo riintegritit të tyre.



### **3.7 Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë**

Secili ent korrektues ka rendin e tij shtëpiak ku parashihen të gjitha të drejta dhe obligime të cialt i kanë fëmijët e dënuar, rendi shtëpiak ju jepet fëmijëve menjëherë pasi ata të paraqiten në institucion korrektues, të drejtat dhe obligimet e fëmijëve janë të parapara sipas ligjit në RMV. Personat e dënuar kanë në dispozicion ligjet, aktet nënligjore të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e mbajtjes së dënimit me burgim, të drejtat dhe obligimet e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burg, rendin shtëpiak të institucionit doracakun për personat e dënuar<sup>58</sup>.

Në institucion nxirret akt i përgjithshëm me të cilin rregullohet rendi shtëpiak dhe në mënyrë më të përafërt përcaktohet organizimi i punës dhe përcaktohen mënyra e jetesës së personave të dënuar në institucion, aktin e përgjithshëm e nxjerr drejtori i institucionit në pajtim me drejtoin e drejtorisë<sup>59</sup>.

Në muajn janar të vitit 2012, drejtorja për zbatimin e sanksioneve noxhri rendin shtëpiak për personat të cilat vuajnë dënimin me burgim në institucionin ndëshkues-korrektues, i cili është i unifikuar dhe vlenë për të gjithë institucionet ndëshkuese- korrektuese. Me këtë rend shtëpiak në mënyrë të përafërt përcaktohet organizimi i punës dhe përcaktohet mënyra e jetesës së personave të dënuar në institucion<sup>60</sup>.

---

<sup>58</sup> Решение за распоредување на осудените, казнетите и малолетни лица во казено-поправните и воспитно-поправните установи („Службен весник на Република Македонија“ бр.84/2008)

<sup>59</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e RMV-së ne. 2/2006,57/10,170/13,43/14, 166/14, 166/14, 33/15, 98/15, 11/16,dhe 08/18 neni 53, paragrafi 1 dhe 2

<sup>60</sup> Куќен ред за осудени лица кои издржуваат казна затвор во казено-поправна установа, јануари 2012 година, Министерство за правда

## Kapitulli IV

### 4. ANALIZË EMPIRIKE LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E MASAVE TË ENTEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

#### 4.1 Analizë e enteve edukuese ku bëhet ekzekutimi i masave edukuese të enteve ndaj fëmijëve në RMV

Entet edukuese në RMV në bazë të analizës së bërë gjatë këtij hulumtimi për këtë punim konstatohet se entet edukuese në RMV nuk janë sipas standarteve europiane dhe rregullave ndërkombëtare të parapara me konventa të ndryshme ku parashihet rregullimi i rendit dhe funksionimit të enteve edukuese për fëmijë.

Në bazë të analizës së bërë në entet edukuese në vendin tonë mungojnë kushtet elementare për të arritur qëllimin e dërgimit të fëmijëve në këto ente, si kushte elementare për higjien, ushqim, rekreacion, arsimim, mjekim.

Shumë ente nuk kanë qendra për studim dhe observim të fëmijëve të dënuar, nuk kanë kuadër të aftë për hartimin e programave të tretmanit dhe kësaj, shpeshherë, kërkesat e tilla mund të shtrohen vetëm si kërkesa teorike, poashtu shpeshherë, ndodhë që raporti në mes të të punësuarëve dhe numri i fëmijëve të dënuar të jetë në disproporcion, në disa ente, në të cilat janë grumbulluar një numër i madh i personave të dënuar e nga ana tjetër ka pak personel puna e të punësuarve profesional është e kufizuar p.sh. për një edukator vjen një numër i madh i fëmijëve të dënuar, cka e vështirson mundësin e punës të sukseshme të edukatorit.<sup>61</sup>

Gjatë hulumtimit për këtë punim kam hasur që në shumë vende të botës ashtu si parashihet teorikisht që lidhja midis mjekut dhe fëmijëve të dënuar funksionon si metodë më e sukseshme për risocializim dhe riintegrim të fëmijëve qëllim i cili është kur fëmijët dërgohen në ente, në vendin tonë nuk funksionon edhe në praktik, pasi teorikisht është paraparë që mjeku të jetë present në entet edukuese, p.sh. në entin edukues korrektues në Ohër nuk ka mjek i cili gjendet në hapësirat e parapara sipas ligjit.

Entet edukues, karakterizohet me mungesë të pajisjeve në ambientet në të cilat janë vendosur fëmijët, hapësirë të kufizuar për lëvizje të fëmijëve, por edhe hapësira të pajisura në mënyrë përkatëse për arsim, plotësim të kohës së lirë, hapësira për aktivitete të lira dhe ngj. Ka mungesë të kuadrit për punë me fëmijë nga aspekti profesional. Mungojnë pedagogë dhe

---

<sup>61</sup> S.Surbatovic, individualni rad vaspitaca osudjenim licima, Penoloski flasnik, nr.6-7, 1985, fq.44-45

punonjës social për punë me këtë kategori fëmijësh, me çka pamundësohet procesi gjithëpërfshirës cilësorë i risocializimit të tyre.

Në vijim të punimit do të ndalem më gjërësisht në analizimin e tre enteve në RMV:

- Enti edukues- korrektues në Tetovë
- Enti edukues – korrektues Ohër
- Enti edukues – korrektues Shkup

Enti edukues korrektues Tetovë- Enti edukues-korrektues-Tetovë është institucion i llojit gjysmë të hapur në të cilin realizohet masa edukuese-dërgim në entin edukues-korrektues të personave të gjinisë mashkullore, të moshës prej 14 deri më 23 vjet, kryrës të veprave penale, të cilëve me aktvendim të gjykatës u është shqiptuar kjo masë. Duke filluar prej datës 14.09.2015 Enti edukues-korrektues-Tetovë funksionon në objekt në përbërje të Institucionit ndëshkues-korrektues Burgu-Ohër. Objekti i institucionit daton prej vitit 1959/60 si pjesë e stacionit policor, ndërsa në vitin 1962/63 ndahet si institucion i 7 veçantë ndëshkues-korrektues në të cilin dërgohen persona të rinj dhe persona të mitur meshkuj të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burg për të mitur, si dhe persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është përcaktuar paraburgimi nga gjykatat themelore rajonale: Dibër, Ohër dhe Strugë, përveç paraburgimit të përcaktuar për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me burg prej më pak se 10 vjet ose burg i përjetshëm ( Aktvendim i Ministrit të drejtësisë për sistematizim të personave të dënuar dhe të mitur në INK dhe IEK dhe të personave të arrestuar në Seksionin për paraburgim të institucionit INK („Gazeta Zyrtare e RM-së” 84/2008 ).<sup>62</sup>

Enti edukues-korrektues Ohër - është në afërsi të Stacionit policor Ohër, i rrethuar me objekte private për banim dhe objekte afariste. Obori i institucionit ndëshkues-korrektues është i ndarë në dy pjesë me gardh të metaltë, Oborin e shfrytëzojnë për aktivitete sportive, lëvizje në ajër të pastër dhe i njëjti mund të shfrytëzohet vetëm në kushte të volitshme atmosferike, pasi është nën qiell të hapur, përkatësisht nuk është i mbuluar.

---

<sup>62</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>



Obori i institucionit për fëmijët e entit edukues korrektues Ohër

Nga ana tjetër, lokaliteti i institucionit ndëshkues-korrektues, (në afërsi të Qendrës së qytetit), ndërkaq në këtë kontekst edhe të pjesës ku janë vendosur fëmijët mund ta vënë në pyetje funksionin e procesit riedukues, nëmes tjerash edhe për shkak të tentimit për ikje, për shkak se vetëm muret e burgut i ndajnë fëmijët nga bota e jashtme, përkatësisht nga lëvizja e lirë. Çështje tjetër është se, sa në kushte të këtilla është mbrojtur privatësia e fëmijëve, kur nga objektet e afërta mundet lehtë të shihet lëvizja e tyre, rreshtimi gjatë ditës, të shkuarit në kuzhinë, shfrytëzimi i kohës së lirë dhe ngj. gjë që në mënyrë të drejtpërdrejtë shprehet edhe ndaj dinjitetit të tyre, sidomos nëse merret parasysh mosha në të cilën gjenden dhe faza e ndjeshme e zhvillimit të tyre psiko-fizik.<sup>63</sup>

Problemi kryesor për funksionimin e entit edukues korrektues është aspekti financiar, enti është i kufizuar me një buxhet të vogël sipas të cilit nuk arrin të sigurojnë kushtet elementare, përpos buxhetit që caktohet nga ana e shtetit enti tenton që nëpërmjet fodacioneve të ndryshme donacioneve, organizatave të ndryshme dhe ndihmave të tjera nga jashtë të siguroj mjete financiare për funksionim.

Enti edukues-korrektues ka kapacitet për vendosje të rreth 35 fëmijëve, Gjithsej të punësuar janë 35 persona, prej të cilëve 25 jane meshkuj ndërsa 10 të gjinisë femërore. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas strukturës nacionale 31 janë Maqedonas, 3 Shqiptarë

<sup>63</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

dhe 1 Rom. Të punësuarit janë të sistematizuar në 11 disa sektore siç janë: Sektori për sigurim, Sektori për risocializim dhe Sektori për punë administrative financiare.<sup>64</sup>

Enti edukues korrektues Shkup - Masa edukuese-korrektuese, drejtimi në ent edukues-korrektues i personave të mitur të gjinisë femërore, ekzekutohet në repartin e grave në Institucionin Ndëshkues-Korrektues “Idrizovë” – Shkup, duke e pasur parasysh faktin se në këtë ent të miturat kanë kontakte të përditshme me të dënuarat, si dhe faktin se nuk aplikohet procesi arsimor, aftësimi profesional, e as programi i hartuar i posaçëm, fitohet përshtypja se vuajtja e masës së entit nuk ekzekutohet me sukses sepse nuk vendoset procesi i mirëfilltë i risocializimit.<sup>65</sup>

Enti funksionon në kushte të cilat nuk korrespondojnë me standardet penologjike, meqë është i vendosur në rrethin e Burgut “Shkup”, dhe kjo nuk lejon që qëllimi i masës së shqiptuar të zbatohet deri në fund, përkatësisht të ketë risocializim efektiv dhe efikas, pra kthimin e të miturit në bashkësi si anëtarë produktiv, i cili nuk do të kryejë më vepra penale, brengos fakti se të miturit kanë kontakte të çdoditshme me popullatën e burgut.<sup>66</sup>

#### 4.2 Numri i fëmijëve të gjykuar me masa të enteve gjatë periudhës kohore: 2015-2020 sipas të dhënave statistikore të entit shtetëror statistikor të RMV-së

| <b>Tabela 1: Numri i fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale gjatë viteve: 2016-2019</b> |      |      |      |      |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------|------|------|
| <b>Viti</b>                                                                                         | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
| <b>Nr i fëmijëve</b>                                                                                | 587  | 578  | 554  | 525  |

(Këshilli SHPDF)

Në tabelën e parë janë paraqitur të dhënat për numrin e fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale gjatë viteve 2016-2019. Në vitin 2016 numri i fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale është 587, në vitin 2017 është 578, në vitin 2018 numri i rasteve të fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale është 554 dhe në vitin 2019 numri i rasteve të fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale është 525.

<sup>64</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

<sup>65</sup> Informacija VPD 2009-ALB

<sup>66</sup> Po aty

| <b>Tabela 2: Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës kohore: 2016-2019</b> |            |             |             |             |             |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Viti</b>                                                                    |            | <b>2016</b> | <b>2017</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> |
| <b>Nr i fëmijëve</b>                                                           | 14-16 vjet | 468         | 368         | 330         | 304         |
|                                                                                | 16-18 vjet | 349         | 256         | 257         | 218         |

(Këshilli SHPDF)

Në tabelën e dytë kemi paraqitur numrin e fëmijëve të cilët janë gjykuar gjatë periudhës kohore 2016-2019 dhe kemi bërë një ndarje sipas moshës së tyre.

Në vitin 2016 numri i fëmijëve të cilët janë të moshës 14-16 vjet të cilët janë gjykuar është 468, në vitin 2017 numri i fëmijëve të cilët janë të moshës 14-16 vjet të cilët janë gjykuar është 368, në vitin 2018 numri i fëmijëve të cilët janë të moshës 14-16 vjet të cilët janë gjykuar është 330, ndërsa në vitin 2019 numri i fëmijëve të gjykuar të kësaj moshe është ulur në 304. Ndërsa numri i fëmijëve të cilët janë gjykuar në periudhën kohore 2016-2019 të cilët janë të moshës 16-18 vjet është: në vitin 2016 janë 349 fëmijë të gjykuar të cilët i takojnë moshës 16-18 vjet, në vitin 2017 janë 256 raste të fëmijëve të cilët janë të gjykuar dhe i takojnë moshës 16-18 vjet, në vitin 2018 kemi 257 raste ku fëmijët janë gjykuar, në vitin 2019 numri i fëmijëve të gjykuar ka pësuar ulje nga vitet paraprake ashtu sic ndodhi tek kategoria e fëmijëve prej 14-16 vjet e njëjta situatë paraqitet edhe te fëmijët të cilët janë të moshës 16-18 vjet me 218 raste, që nënkupton se kemi 131 raste më pak se në vitin 2016.

| <b>Tabela 3: Llojet e veprave penale të kryer nga fëmijët gjatë viteve 2016-2019</b> |              |             |             |             |
|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Lloji i vepra penale</b>                                                          | <b>Vitet</b> |             |             |             |
|                                                                                      | <b>2016</b>  | <b>2017</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> |
| Kundër Jetës dhe trupit                                                              | 872          | 774         | 969         | 955         |
| Kundër Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit                                 | 435          | 432         | 464         | 567         |
| Kundër lirisë dhe moralit seksual                                                    | 78           | 55          | 62          | 40          |
| Kundër financave publike dhe ekonomisë                                               | 333          | 309         | 210         | 213         |
| Kundër pasurisë                                                                      | 4221         | 3595        | 4056        | 3967        |

|                                                         |              |              |              |              |
|---------------------------------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Kundër Martesës dhe familjes                            | 421          | 353          | 434          | 460          |
| Kundër Sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pasurisë | 162          | 177          | 158          | 235          |
| Kundër Sigurisë në komunikacion publik                  | 2595         | 2505         | 2400         | 2482         |
| Kundër komunikacionit të rregulluar                     | 419          | 290          | 365          | 348          |
| Kundër Rendit publik                                    | 581          | 550          | 731          | 877          |
| Kundër Detyrës zyrtare                                  | 584          | 561          | 608          | 708          |
| Dhe vepra të tjera                                      | 1165         | 996          | 1132         | 1403         |
| <b>Gjithësej</b>                                        | <b>11880</b> | <b>10603</b> | <b>11609</b> | <b>12255</b> |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e tretë janë paraqitur Llojet e veprave penale të kryera nga fëmijët gjat vitit 2016 sipas entit statistikor të RMV-së kemi: kundër jetës dhe trupit 872 vepra penale, kundër lirisë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit 435 vepra penale, kundër lirisë dhe moralit seksual 78 vepra penale, kundër financave publike dhe ekonomisë 333 vepra penale, kundër pasurisë janë veprat të cilat janë përsëritur më së shumti në vitin 2016 nga fëmijët saktësishtë 4221 vepra penale, kundër martesës dhe familjes 421 vepra penale, kundër sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pasurisë 162 vepra penale, kundër sigurisë në komunikacion publik 2595 vepra penale, kundër komunikacionit të rregulluar 419, kundër rendit publik 581, kundër detyrës zyrtare 584 dhe vepra të tjera penale 1165.

Ndërsa gjatë vitit 2017 kemi: kundër jetës dhe trupit 774 vepra penale, kundër lirisë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit 432 vepra penale, kundër lirisë dhe moralit seksual 55 vepra penale, kundër financave publike dhe ekonomisë 309 vepra penale, kundër pasurisë janë veprat të cilat janë përsëritur më së shumti në vitin 2017 nga fëmijët saktësishtë 3595 vepra penale, kundër martesës dhe familjes 353 vepra penale, kundër sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pasurisë 177 vepra penale, kundër sigurisë në komunikacion publik 2505 vepra penale, kundër komunikacionit të rregulluar 290, kundër rendit publik 550, kundër detyrës zyrtare 561 dhe vepra të tjera penale 996.

Kurse gjatë viti 2018 kemi këto statistika: kundër jetës dhe trupit 969 vepra penale, kundër lirisë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit 464 vepra penale, kundër lirisë dhe moralit seksual 62 vepra penale, kundër financave publike dhe ekonomisë 210 vepra penale, kundër pasurisë janë veprat të cilat janë përsëritur më së shumti edhe në vitin 2018 njëjtë si dy vitet

paraprake nga fëmijët saktësishtë 4056 vepra penale, kundër martesës dhe familjes 434 vepra penale, kundër sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pasurisë 158 vepra penale, kundër sigurisë në komunikacion publik 2400 vepra penale, kundër komunikacionit të rregulluar 365, kundër rendit publik 731, kundër detyrës zyrtare 608 dhe vepra të tjera penale 1132.

Në vitin e fundit të analizës të statistikave të veprapve penale të kryer nga fëmijët : kundër jetës dhe trupit 955 vepra penale, kundër lirisë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit 567 vepra penale, kundër lirisë dhe moralit seksual 40 vepra penale, kundër financave publike dhe ekonomisë 213 vepra penale , kundër pasurisë janë veprat të cilat janë përsëritur më së shumti edhe në vitin 2019 nga fëmijët saktësishtë 3967 vepra penale, kundër martesës dhe familjes 460 vepra penale, kundër sigurisë së përgjithshme të njeriut dhe pasurisë 235 vepra penale, kundër sigurisë në komunikacion publik 2482 vepra penale, kundër komunikacionit të rregulluar 348, kundër rendit publik 877, kundër detyrës zyrtare 708 dhe vepra të tjera penale 1403. Në vitin 2019 janë kryer më së shumti vepra penale nga fëmijët në krahasim me 3 vitet paraprake ku në total në vitin 2019 kemi 12255 vepra penale të kryer nga fëmijët.

| <b>Tabela 4: Fëmijët e gjykuar nga gjykata themelore me masa alternative</b> |                                    |                         |                |                                                     |                                           |                           |                      |
|------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-------------------------|----------------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------|----------------------|
| <b>Vitet</b>                                                                 | <b>Masat alternative-gjithësej</b> | <b>Denimet me kusht</b> |                | <b>Gjykim me kusht –me mbikëqyrje të përforcuar</b> | <b>Shfytëzim për punë të përgjithshme</b> | <b>Vërejtje gjyqësore</b> | <b>Burg shtëpiak</b> |
|                                                                              |                                    | <b>Burg</b>             | <b>Me para</b> |                                                     |                                           |                           |                      |
| <b>2016</b>                                                                  | 4332                               | 4179                    | 92             | -                                                   | -                                         | 61                        | -                    |
| <b>2017</b>                                                                  | 3534                               | 3350                    | 138            | -                                                   | -                                         | 46                        | -                    |
| <b>2018</b>                                                                  | 3454                               | 3307                    | 108            | -                                                   | -                                         | 39                        | -                    |
| <b>2019</b>                                                                  | 2526                               | 2409                    | 72             | 1                                                   | 1                                         | 42                        | 1                    |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e katërtë kemi paraqitur të dhëna nga fëmijët të cilët janë gjykuar nga gjykata themelore me masa alternative në periudhën kohore 2016-2019.

Në vitin 2016 kemi 4332 raste ku fëmijët janë gjykuar me masë alternative nga të cilat 4179 janë me burg, 92 janë me para, dhe 61 janë vërejtje gjyqësore. Në vitin 2017 kemi 3534 raste të fëmijëve që janë gjykuar me masë alternative nga të cilat 3350 janë me burg, 138 janë me para dhe 46 janë me vërejtje gjyqësore. Në vitin 2018 kemi 3454 raste të fëmijëve që janë



gjykuar me masë alternative nga të cilat 3307 janë me burg, 108 janë të gjykuar me para dhe 39 me vërejtje gjyqësore. Në vitin 2019 gjendja ndryshon, ku nga gjykata themelore janë shqiptuar edhe lloje të tjera të masave alternative.

Mirëpo duhet potencuar se numri është zvogluar dukshëm në krahasim me vitet tjera, duke pasur parasysh se në vitin 2016 kishim 4332 raste ndërsa në vitin 2019 kemi 2526 raste nga të cilat 2409 janë me burgim, 72 janë të gjykuar me para, lloji i ri që na paraqitet në vitin 2019 është gjykimi me kusht me mbikqyrje të përforcuar ku kemi 1 rast, poashtu për dallim nga vitet tjera kemi 1 fëmijë të gjykuar nga gjykata themelore me masë: shfrytëzim për punë të përgjithëshme, masë e cila nuk është shqiptuar në vitet paraprake, me vërejtje gjyqësore kemi 42 raste dhe burg shtëpiak si masë alternative e shqiptuar vetëm në vitin 2019 kemi 1 rast.

| <b>Tabela 5: Të miturit e akuzuar sipas vendimit dhe gjinis</b> |                                  |               |                   |                                     |                                          |                            |                                 |
|-----------------------------------------------------------------|----------------------------------|---------------|-------------------|-------------------------------------|------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------|
| <b>Vitet</b>                                                    | <b>Fëmijët<br/>e<br/>akuzuar</b> | <b>Femrat</b> | <b>Përgjegjës</b> | <b>Procedur<br/>e<br/>ndërprerë</b> | <b>Të<br/>liruar<br/>prej<br/>akuzës</b> | <b>Akuz e<br/>refuzuar</b> | <b>Masat<br/>e<br/>sigurise</b> |
| <b>2016</b>                                                     | 9320                             | 868           | 8172              | 579                                 | 235                                      | 307                        | 27                              |
| <b>2017</b>                                                     | 7423                             | 677           | 6273              | 590                                 | 208                                      | 310                        | 42                              |
| <b>2018</b>                                                     | 6829                             | 524           | 5857              | 441                                 | 244                                      | 272                        | 15                              |
| <b>2019</b>                                                     | 5370                             | 485           | 4513              | 287                                 | 183                                      | 188                        | 199                             |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e pestë janë paraqitur të dhëna për të miturit që janë të akuzuar sipas llojit të vendimit dhe gjinis. Në vitin 2016 kemi më së shumti fëmijë të akuzuar të cilët janë 9320, nga të cilat 868 janë femra, në vitin 2017 kemi 7423 nga të cilat 677 janë femra, 2018 kemi 6829 nga të cilat 524 janë femra dhe në vitin 2019 kemi 5370 nga të cilat 485 janë femra, fëmijë të akuzuar, sic shihet nga të dhënat e paraqitura numri i fëmijëve të akuzuar ka pësuar ulje nga viti në vit, gati rastet e fëmijëve të akuzuar janë përgjysmuar në krahasim nga viti 2016 në vitin 2019, ku në vitin 2019 kemi 3950 më pak fëmijë të akuzuar se në vitin 2016.

Në vitin 2016, 8172 të mitur janë shpallur përgjegjës për kryerjen e veprave penale, në vitin 2017 janë shpallur 6273 fëmijë përgjegjës për veprën e kryer, në vitin 2018 janë shpallur

5857 fëmijë përgjegjës për veprën e kryer dhe në vitin 2019 janë shpallur 4513 fëmijë përgjegjës për vepër penale të caktuar.

Në procedurë të ndërprerë gjyqësore në vitin 2016 kemi 579 raste, në vitin 2017 kemi 590 rast në procedurë të ndërprerë, në 2018 kemi 441 raste dhe në vitin 2019 kemi 287 raste në procedurë të ndërprerë gjyqësore.

Të liruar nga akuza në vitin 2016 kemi 235 të mitur, në vitin 2017 kemi 208 të mitur, në vitin 2018 të liruar nga akuza kemi 244 fëmijë, ndërsa në vitin 2019 të liruar prej akuzes kemi 183 raste.

Akuza të refuzuara për fëmijë gjatë vitit 2016 kemi 307, në vitin 2017 kemi 310 akuza të refuzuara, në vitin 2018 kemi 272 akuza të refuzuara dhe në vitin 2019 kemi më së paku se vitet tjera 188 akuza të refuzuara.

Masat e sigurisë në vitin 2016 ndaj të miturve janë shqiptuar 27, në vitin 2017 kemi 42 masa të sigurisë të shqiptuara, në vitin 2018 kemi 15 dhe në vitin 2019 kemi një ritje të dukshme në krahasim me vitet tjera ku janë shqiptuar 199 masa të sigurisë.

| <b>Tabela 6: Rastet e fëmijëve të paraqitur si kryerës të V.P. që janë në procedurë gjyqësore</b> |                                             |                                    |                                  |                 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------|----------------------------------|-----------------|
| <b>Vitet</b>                                                                                      | <b>Propozim I paraqitur për dënim- masë</b> | <b>Procedura nuk është inicuar</b> | <b>Procedura është ndërprerë</b> | <b>Gjithsej</b> |
| <b>2016</b>                                                                                       | 379                                         | 122                                | 86                               | 587             |
| <b>2017</b>                                                                                       | 370                                         | 113                                | 95                               | 578             |
| <b>2018</b>                                                                                       | 318                                         | 158                                | 78                               | 554             |
| <b>2019</b>                                                                                       | 358                                         | 123                                | 44                               | 525             |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e gjashtë janë paraqitur rastet e fëmijëve të paraqitur si kryerës të veprave penale që janë në procedurë gjyqësore. Në vitin 2016 propozim për dënim apo masë është dhënë për 379 fëmijë, në vitin 2017 i njëjti propozim është dhënë për 370 fëmijë, në vitin 2018 kemi 318 raste ku është paraqitur propozimi për dënim dhe në vitin 2019 kemi 358 raste ku është paraqitur propozimi për dënim apo masë ndaj fëmijëve.

Rastet ku procedura nuk është inicuar në vitin 2016 kemi 122, në vitin 2017 kemi 113 raste ku procedura nuk është inicuar, në vitin 2018 kemi 158 raste ku procedura nuk është inicuar dhe në vitin 2019 kemi 458 raste ku procedura nuk është inicuar.

Rastet ku procedura është ndërprerë janë më të pakta në krahasim me procedurat tjera gjyqësore të cilat janë: në vitin 2016 kemi 86 raste ku procedura është ndërprerë, në vitin 2017 kemi 95 raste, në vitin 2018 kemi 78 raste dhe me 44 raste të cilat njëherësh janë edhe më të pakta janë në vitin 2019 raste ku procedura është ndërprerë.

Nga këto statistika të paraqitura vimë në përfundim se rastet e fëmijëve në procedurë gjyqësore janë shumë të përafërta duke filluar me vitin 2016 vit të cilin kemi paraqitur të dhëna është me gjithësej 587 raste, në vitin 2017 gjithësej kemi 578 raste, vitin 2018 e kemi mbyllur me 554 raste dhe vitin 2019 është me 525 raste të fëmijëve në procedurë gjyqësore.

| <b>Tabela 7: Numri i fëmijëve të dënuar me masa gjatë periudhës kohore 2016-2019 prej moshes 14-16 vjet</b> |             |             |             |             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Viti</b>                                                                                                 | <b>2016</b> | <b>2017</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> |
| Masat disiplinore                                                                                           | 11          | 11          | 10          | 20          |
| Masa të përforcuara                                                                                         | 100         | 57          | 57          | 60          |
| Masat institucionale                                                                                        | 8           | 6           | 6           | 2           |
| <b>Gjithsej</b>                                                                                             | <b>119</b>  | <b>73</b>   | <b>73</b>   | <b>82</b>   |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e shtatë janë paraqitur masat e shqiptuar ndaj fëmijëve të moshës 14 deri 16 vjet nga vitit 2016 deri në vitin 2019, jemi fokusuar te shqiptimi i masave edukuese, duke filluar nga masat disiplinore që në vitin 2016 dhe në vitin 2017 kemi nga 11 masa disiplinore të shqiptuara, në vitin 2018 kemi 10 masa dhe në vitin 2019 kemi 20 masa disiplinore.

Tek masat e mbikëqyrjes së përforcuar në vitin 2016 janë shqiptuar 100 masa të ketij lloji, në vitin 2017 kemi 97 masa të mbikëqyrjes së përforcuar, në vitin 2018 kemi 57 masa dhe në vitin 2019 kemi 60 raste ku është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar..

Ndërsa masat institucionale gjatë vitit 2016 janë shqiptuar vetëm 8 herë, gjatë vitit 2017 4 herë, gjatë vitit 2018 6 herë dhe më së paku në vitin 2019 ku kemi të shqiptuar vetëm 2 herë masat institucionale .

Në vitin 2016 gjithësej kemi 119 raste ku janë shqiptuar masa edukuese ndaj fëmijëve, në vitin 2017 kemi 112 raste ku janë shqiptuar masat edukuese, në vitin 2018 kemi 73 raste ku janë shqiptuar masat edukuese dhe në vitin 2019 gjithësej kemi 82 raste ku janë shqiptuar masat edukuese ndaj fëmijëve.

| <b>Tabela 8: Numri i fëmijëve të dënuar me masa gjatë periudhës kohore 2016-2019 prej moshës 16-18 vjet</b> |                          |                                          |                             |                 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|------------------------------------------|-----------------------------|-----------------|
| <b>Vitet</b>                                                                                                | <b>Masat Edukuese</b>    |                                          |                             | <b>Gjithsej</b> |
|                                                                                                             | <b>Masat disiplinore</b> | <b>Masat e mbikëqyrjes së përforcuar</b> | <b>Masat institucionale</b> |                 |
| <b>2016</b>                                                                                                 | 39                       | 304                                      | 2                           | <b>345</b>      |
| <b>2017</b>                                                                                                 | 39                       | 203                                      | 9                           | <b>251</b>      |
| <b>2018</b>                                                                                                 | 36                       | 208                                      | 10                          | <b>254</b>      |
| <b>2019</b>                                                                                                 | 30                       | 185                                      | 1                           | <b>216</b>      |

(Enti statistikor i RMV-së)

Në tabelën e tetë janë paraqitur masat e shqiptuar ndaj fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjet nga vitit 2016 deri në vitin 2019, jemi fokusuar te shqiptimi i masave edukuese, duke filluar nga masat disiplinore që në vitin 2016 dhe në vitin 2017 kemi nga 39 masa disiplinore të shqiptuara , në vitin 2018 kemi 36 masa dhe në vitin 2019 kemi 30 masa disiplinore.

Tek masat e mbikëqyrjes së përforcuar në vitin 2016 janë shqiptuar 304 masa të këtij lloji, në vitin 2017 kemi 203 masa të mbikëqyrjes së përforcuar, në vitin 2018 208 masa dhe në vitin 2019 kemi me pak masa të mbikëqyrjes së përforcuar gjithsej 185.

Ndërsa masat institucionale gjatë vitit 2016 janë shqiptuar vetëm dy herë, gjatë vitit 2017, nëntë herë, gjatë vitit 2018 dhjetë herë dhe më së paku në vitin 2019 ku kemi të shqiptuar vetëm një masë institucionale .

Nga tabela e paraqitur vërehet një rënie e masave edukuese të shqiptuara nga viti në vit duke filluar nga 2016 ku kemi më së shumti masa të shqiptuara me gjithsej 345, duke rënë në vitin 2017 në 251 masa të shqiptuara, 2018 në 254 dhe në vitin 2019 kemi më së paku masa edukuese të shqiptuara me gjithsej 216.

## Përfundim

Si përfundim pasi që elaboruam në mënyr të përgjithshme mbi ekzekutimin e masave të enteve në Republikën e Maqedonisë së veriut, munë të vijmë në përfundim se kriminaliteti i fëmijëve është një ndër fenomenet më të rrezikshme që i kanoset shoqërisë tonë në përgjethsi, duke parë gjendjen ekonomike në vend dhe kushtet nëpër entet edukuese - korrektuese. Ekzekutimi i masave për fëmijë në RMV është i rregulluar konform kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare të drejtësisë për fëmijë.

Ligji për ekzekutimin e masave për fëmijë garanton barazi dhe paanshmëri, ndalon diskriminimin në bazë të racës, gjinis, gjuhës dhe fesë, ligji është në bazë të të gjitha standarteve europiane ku parashihen respektimi i të gjitha të drejtave të fëmijëve dhe zbatohen masat duke filluar nga më të lehtat deri tek masa me burgim e cili parashihet si masë e fundit që u shqiptohet fëmijëve në proesin e riedukimit dhe riintegrit.

Ekzekutimi i masave ndaj fëmijëve has në ngecje në drejtimin de factokur ndaj fëmiut ndërmerren masa në kuadër të tretmanit penitensiar në entin e caktuar korrektues ndëshkues ku ekzekutohet ky lloj i masës. Kushtet të cilat ofrohen nga ana e shtetit në këtë ent nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme që tek fëmijët e sanksionuar të arrihet efekti i këtij dënimi- edukimi, socializmi, si dhe prevencioni special.

Kushtet sanitare, numri i personalit si dhe programet joadekuate për riedukim të fëmijëve të sanksionuar paraqesin problematikë shumë serioze e cila në praktikë nuk lejon që ekzekutimi i masave ndaj të fëmijëve të arrijë efektin e kërkuar. Problematika më e madhe që është hasur në këtë hulumtim janë zbatimi i masave nëpër ente për shkak të kushteve me të cilat përballen fëmijët në ent, duke parë se entet nuk i plotësojnë kushtete që janë të parapara me ligj dhe në bazë të standarteve ndërkombëtare dukshëm ndikojnë në procesin e riedukimit dhe riintegrit, prandaj mundë të vijmë në përfundim se në vendin tonë ky proces është shumë problem për të arritur efikasitetin e tij tek fëmijët.

Duke parë të dhënat që kemi paraqitur në punim, vijmë në përfundim se duhet shtim të personelit dhe angazhim më serioz i të punuarëve në institucione korrektuese dhe që në vazhdimësi të përmirësohen kushtet metodat dhe mjete të cilat përdoren për risocializim të fëmijëve. Nga kjo që kemi hulumtuar mundë të konstatojm se zbatimi i masave për fëmijë në praktikë nëpër entet edukuese nuk na jep garancion për një edukim apo riedukim të plotë dhe riintegrit të sigurt të fëmiut në shoqëri.

## **Rekomandim**

Si pikë e parë mendoj se në Republikën e Maqedonisë së Veirut duhet shtuar numëri i enteve edukuese vecanërisht në qytetet më të mëdha dhe gjithashtu disa enteve që ekzistojnë u duhet lokacion i ri që ti plotësoj kushtet që janë të parapara me ligj.

Rekomandimi im është që në Tetov duhet urgjentish të reagohet që të ndërtohet enti edukues përmirësues i cili si pasojë e konfliktit të vitit 2001 mbeti I djegur dhe jofunksional edhe pse tashmë kanë kaluar 19 vite nga lufta, ky ent është I nevojshëm në Tetov për shkak të numrit të madhë të banorëve që ka, dhe duke nisur nga fakti se është shumë I shprehur kriminaliteti te fëmijët edhe pse ndoshta ne organet e policës benë pjesë të rastet e numrit të errët të kriminaliteti sepse janë të pakët ato rastë që paraqiten denoncohen në polici.

Përmirësimi I kushteve nëpër ente është sfida e radhës që për shtetin tonë duhet të kthehet në qëllim primar pasi me këto lloj kushtesh nëpër institucionet edukuese fëmijët përjetojnë vetëm heqjen e lirës për sa kohë gjenden në ent dhe hakmarjen ose shpagimin për të keqen që kanë bërë fëmijët, dhe nuk I përfitojnë qëllimet që kanë masat si psh. me shqiptimin e masave- duhet të arihet riedukimin dhe riintegrimi i fëmijëve, aftësimi i tyre profesional, gjithashtu masat duhet të ndikojnë pozitivisht në të përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për të parandaluar recidivizmin. Pra duhet përmirësim te kushteve, duke filluar prej higjienës, ngrohjes, hapsirave për aktivitete zbvitëse, duhet siguruar që mrenda në ent të ketë profesorë I cili do I mbajë orët mësimore dhe mjek të specializuar I cili do të qëndrojë në ambientet e burgut sipas dispozitave ligjore të RMV-së.

Luftimi I kriminaliteti me strategji nga ana e shtetit, një ndër pikat më të forta që do të ndikonte në renjën e kriminaliteti të fëmijët është gjenjda ekonomike e familjeve në RMV, duke parë se forma më e shpesht e veprës penale tek fëmijët është ajo kundër pasurisë, duke pasur parasysh këtë karakteristikë shteti duhet të reagoj dhe tu mundësoj kushte më të mira për jetesë të gjitha kategorive të familjeve, të siguroi ndihma të mjaftueshme për jetë normale për rastet sociale, ndihmesë financiare ndaj fëmijëve të cilët janë raste sociale, asistencë pa pagesë mjeksore dhe politika të ndryshme për të ndikuar në ngritjen e nivelit ekonomik në familjet dhe shoqërinë e vendit tonë.

Ngritja e një komisioni mbikëqyrës të pavarur I cili do të merte fonde nga shteti dhe nga organizata të ndryshme jo qeveritare të cilat kanë për qëllim luftimin e kriminalitetit të fëmijët, gjithashtu propozimet vendimet e këtij komisioni të kenë rëndësi dhe të përfillen nga shteti, ky

komision të mbikëqyr se si zhvillohet zbatimi i masave për fëmijë qoftë në ente edukuese permirësuese korrektuese ose edhe të masave më të lehta ku përkujdesen prindërit ose tutori.

Në sistemin edukativo arsimorë e cila është një pikë shumë e fort ku nëpërmjet procesit mësimor mund të ketë ndikim të madhë ne parandalimin e kriminalitetit tek fëmijët, rekomandoi që prej klasesë së 7 fillore të ketë lëndë të posacme për kriminalitetin e fëmijëve me qëllim që fëmijët të jenë më të informuar se cilat veprime janë të ndaluara dhe shpion në kriminalitet, tu tregohet për pasojat dhe dëmet që shkaktojnë në të ardhmen. Gjithashtu mendoi se që kjo lëndë të jetë sa më efikase dhe tërheqëse në të njëjtën kohë për fëmijet, duhet që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendëshme të ken qasje dhe bashkpunim me institucionet shkollore ku do të zhvillojnë ligjerat dhe trajnime të ndryshme me të vërtmin qëllim luftimin e kriminalitetit tek fëmijët.



## Literatura

- Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015
- Salihu, I. (2012) E drejta penale
- Osmani, A. (2013) Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve.
- Ahmedi Arifi, B. (2018) Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015
- Halili, R. (2014) Penologjia
- Ahmedi Arifi, B. (2019) Delikuenca e të miturve.
- Hajdari, A. (2010). Sistemi i Drejtësisë për të mitur. Prishtinë.
- Arifi, B. (2017). THE CHILD CRIME PHENOMENON IN REPUBLIC OF MACEDONIA: 2006-2015. ANNUAL of ISPJR , XLI (I), 103-104.
- Božičević-Grbić M. & Roksandić Vidlička S. (2011). Reforma maloljetničkog prava i sudovanja, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu. [Croatian Annual for Criminal Laë and Practice], Vol. 18, No. 2, , 715.
- Hajdari, A. (2010). Sistemi i Drejtësisë për të mitur. Prishtinë.
- INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur. Shkup: Këshilli shtetëror për parandalim të delikuençës së fëmijëve, (2013).
- Kambovski, V. (2007). E DREJTA PENALE Pjesa e përgjithshme. Shkup: Furkan ISM.
- Kambovski, V., Maloletnicka pravda, Shkup, 2008
- Кнежевиќ, С. (2010). Малолетничко кривично право- материално, процесно и извршно, Пројект: Право на приступ правосуду, Ниш.
- Kryerës të veprave penale në 2013. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2013", Statistical revievë / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.14.11 (789) p.117. (2014).
- Kryerës të veprave penale në 2014. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2014", Statistical revieë / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.15.12 (823) p.115. (2015).

- Kryerës të veprave penale në 2015. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2015", Statistical revieë, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.16.08 (8544). (2016).
- Kryerës të veprave penale në 2017 Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2015", Statistical revieë, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.18.07 (898)
- Latifi, V. (1982). Kriminalistika e delikuencës së të miturve. Prishinë: Rilindja.
- Latifi, V., Elezi, I., Hysi ,V. "POLITIKA E LUFTIMIT TË KRIMINALITETIT", Prishtinë, 2012
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)
- Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF. (2016). Raport Vjetor për Punën e Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve dhe për gjendjet në sferën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së fëmijëve në vitin 2015. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)
- Sahiti E., Zejneli I. (2007, 2017). E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë. Tetovë.
- Sahiti, E. (1993). Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale. Prishtinë.
- Strategjia për Parandalim. (2010). Strategjia Nacionale për parandalim të delikuencës së të miturve 2010-2020. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së të miturve ("Национална Стратегија за Превенција на Малолетничко Престапништво 2010-2020").
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Rijadit); Titulli original: UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (Riyadh Guidelines)
- Zejneli, I. (2008). Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë. Tetovë.
- Zejneli, I. (2018). Delikuenca e të miturve. Tetovë/ Prishtinë.

### **Konventa, kushtetuta, kode, ligje**

- Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child- (CRC))
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52 nga 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese I-XXXII. Shkup.
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr: 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave. “Gazeta Zyrtare e F.D.” nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90, 38/90, dhe “G.Z. e R.M.” nr. 25/92, 32/93.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë. “Gazeta Zyrtare e R.S.M.”, nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89, 7/90, 23/91, 24/92, 49/93.
- Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë. (2007). (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008 dhe 145/10).
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë.” nr. 148 /2013.
- Ligji mbi Policinë i Republikës së Maqedonisë (Tekst i Spastruar). (Mars, 2015). (“Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 114/04, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 148/08).

### **Publikime në sajte**

- <http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>
- <https://www.zeriamerikes.com/a/drejtesia-per-te-mitur/2939399.html>. (31.08.2016).
- <https://www.unicef.org>.
- <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>